

# MEDIA DHE KORONAVIRUSI

- Udhëzime për gazetarët që raportojnë pandeminë-



Tiranë, 2020

Media dhe Koronavirusi

- Udhëzime për gazetarët që raportojnë pandeminë-

© i botimit shqip 2020 Instituti Shqiptar i Medias



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*

Ky botim u mundësua me mbështetjen e *National Endowment for Democracy*, në kuadrin e projektit të zbatuar nga *SEENPM* “*Debunking Misinformation in South East Europe.*”



**Albanian Media Institute  
Instituti Shqiptar i Medias**

Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

Tel./fax: ++ 355 4 2229800

E-mail: [info@institutemedia.org](mailto:info@institutemedia.org)

[www.institutemedia.org](http://www.institutemedia.org)

## Tabela e përmbajtjes



Epidemi Gënjeshtresh: Keqinformimi dhe Koronavirusi

5



Etika e medias, siguria dhe shëndeti mendor: raportimi në kohën e COVID-19

45



Dhjetë këshilla për mediat gjatë 'infodemisë' së COVID-19

57



Konsiderata etike për raportimin mbi COVID-19

63





# EPIDEMI GËNJESHTRASH: KEQINFORMIMI DHE KORONAVIRUSI



## Përmbledhje e përgjithshme

---

Gjatë këtyre tre muajve të fundit, COVID-19, sëmundja e shkaktuar nga një lloj i ri koronavirusi, shpërtheu anembanë botës. Përhapja e shpejtë e virusit u shoqërua hap pas hapi nga shpërndarja e dezinformatave, dhe nga shpërthimi i ‘gjuhës së urrejtjes’ kundër personave me prejardhje kineze apo aziatike. Liria e shprehjes ishte një nga viktimat e kësaj epidemie, pasi disa qeveri vendosën censurë ndaj medias, kryen arrestime, dhe zbatuan ligje shtypëse për t’u përballur me situatën e krijuar, dhe për të kontrolluar narrativat publike në lidhje me krizën.

Në muajin shkurt, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) shprehu shqetësimin e saj në lidhje me shpërthimin e një “epidemie keqinformimi” të shkaktuar nga valë të shpeshta informacionesh të rreme dhe dezinformatash mbi COVID-19. Postimet në faqet e mediave sociale që paraqesin kura të rreme, teori konspiracioni, dhe informacione të pasakta mbi mënyrën e shpërndarjes së virusit lexohen më shpesh nga publiku, në krahasim me informacionet që dalin nga burime dhe autoritete të specializuara. Herë pas here, informata të rreme depërtojnë edhe në raportimet e mediave tradicionale. Në shumë raste, dezinformacioni ka shpërqendruar edhe vëmendjen e autoriteteve shtetërore, ka nxitur frymën e mosbesimit ndaj qeverive, dhe ka krijuar pështjellim në publik.

Gjithashtu, epidemia COVID-19 ka shkaktuar frikë, diskriminim dhe intolerancë në shumë vende të botës. Individë dhe komunitete që preken nga kjo valë e ‘gjuhës së urrejtjes’ kanë frikë se kjo retorikë agresive mund të përshkallëzohet në akte dhune apo diskriminimi.

Nganjëherë qeveritë kanë ndërmarrë masa tepër agresive dhe kundërproduktive në përballjen me sfidat e krijuara nga kjo situatë. Kështu, përpjekjet nga ana e autoriteteve kineze

për të frenuar raportimin nga ana e publikut mbi daljen në skenë të COVID-19 e vështirësuan përballjen me krizën gjatë fazave fillestare të shpërthimit të epidemisë. Disa nga qeveritë e vendeve të Azisë Juglindore vunë në zbatim legjislacione represive, duke arrestuar dhe duke ngritur akuza kundër individëve që presupozohej se shpërndanin informata të rreme mbi COVID-19. Autoritetet iraniane arrestuan përdorues të mediave sociale që postonin materiale mbi virusin, ndërkohë që bllokoi informacionin mbi shpërthimin e epidemisë.

Gazetarët e pavarur, qytetarët reporterë, diskutimi i hapur publik, dhe rrjedha e lirë e informacionit janë elementë të domosdoshëm për mbështetjen e përpjekjeve mbarëbotërore në luftën kundër COVID-19. Qeveritë duhet të hartojnë politika dhe të marrin masa kundër epidemisë duke respektuar lirinë e shprehjes dhe aksesin në informacion. Politikat e përballjes me keqinformimin dhe 'gjuhën e urrejtjes' që risjellin në skenë censurën dhe ndëshkimet penale, duhet të zëvendësohen me politika dhe masa që e vënë theksin mbi transparencën dhe lirinë e medias.

Nga ana tjetër, edhe kompanitë mediatike dhe ato të mediave sociale duhet të kontribuojnë në luftën kundër keqinformimit dhe 'gjuhës së urrejtjes' në lidhje me krizën e COVID-19. Gazetarët duhet të raportojnë në mënyrë të saktë, pa paragjykime, duhet të diktojnë dhe të investigojnë fushatat propagandistike dhe diskriminim nga ana e autoriteteve, si dhe të krijojnë hapësira dhe mundësi për korrigjime gabimesh dhe të drejtën e replikës. Kompanitë e mediave sociale duhet të vazhdojnë të bashkëpunojnë me OBSH-në dhe autoritetet e shëndetit publik për të mundësuar shpërndarjen e informacioneve të sakta mbi COVID-19, që bazohen mbi të dhëna nga burime të specializuara. Po kështu, ato duhet të sigurohen që masat kundër dezinformatave dhe 'gjuhës së urrejtjes' të bazohen mbi rregulla të qarta dhe të kuptueshme për të shmangur shkeljet e të drejtave të përdoruesve.



## Hyrje

---

COVID-19, që më parë njihej me emrin 'koronavirusi i ri 2019' është një sëmundje që shkaktohet nga një lloj i ri virusi nga familja e koronavirusëve.<sup>1</sup> Megjithëse shumica e rasteve me COVID-19 kalojnë pa probleme, raste të rënda të sëmundjes mund të shkaktojnë pneumoni, dhe një përqindje e vogël e këtyre rasteve përfundojnë me vdekje. Autoritetet e shëndetit publik e identifikuan për herë të parë COVID-19 në qytetin Wuhan, në provincën kineze Hubei, në dhjetor 2019. Deri më 6 mars 2020, ishin regjistruar 95,270 raste të konfirmuara në 79 shtete, me 3,280 të vdekur.<sup>2</sup>

Gjatë javëve të para pas identifikimit të COVID-19, qeveria kineze u mundua të kontrollonte në mënyrë agresive narrativën në lidhje me shpërthimin e epidemisë. Autoritetet fshehën një pjesë të informacionit nga publiku, raportuan sistematikisht shifra më të ulëta infektimi në krahasim me realitetin, vendosën kontroll të fortë shtetëror mbi raportimin e medias shtetërore, vendosën censurë mbi forumet dhe shkëmbimin e mesazheve në internet, arrestuan denoncues dhe informatorë, si dhe sulmuan në mënyrë të vazhdueshme individë aktivë në internet, gazetarë dhe punonjës të shëndetit publik që shkëmbejnë informacion mbi këtë sëmundje.<sup>3</sup> Sipas ekspertëve, ky shtrëngim informacioni mbi COVID-19 ndikoi negativisht në kundërpërgjigjen ndaj shpërthimit të epidemisë.<sup>4</sup>

Në muajin shkurt, pakënaqësia dhe acarimi i mbajtur përbrenda shpërtheu publikisht pas vdekjes së Li Wenliang, një mjek 33 vjeçar që humbi jetën nga COVID-19. Ai ishte një nga të parët që ngriti shqetësimin mbi këtë sëmundje, por më pas u ndalua nga policia me akuzën e "shpërndarjes së informatave të rreme në internet," dhe u detyrua të nënshkruante një deklaratë ku pranonte se ishte "sjellë në mënyrë të paligjshme". Një numër

i madh kinezësh e injoruan censurën shtetërore në nderim të vdekjes së doktorit, dhe kërkuan llogari në lidhje me punën e qeverisë në përballimin e krizës.<sup>5</sup>

Ndërsa COVID-19 filloi të shpërndahej në vendet fqinje, dhe më pas nëpër të gjithë botën, qeveri dhe popuj të tërë u përballën me një mori gënjeshtrash, mitesh dhe raportimesh të pasakta në internet, dhe nganjëherë këto pasaktësi përçoheshin edhe nga mediat tradicionale. Në muajin shkurt, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) shprehu shqetësime në lidhje me shpërthimin e një “epidemie masive keqinformimi” mbi COVID-19, që “i krijon vështirësi publikut në gjetjen dhe identifikimin e burimeve serioze të informacionit për t’u orientuar në këto momente krize”.<sup>6</sup> Po kështu, OBSh ka ngritur vazhdimisht shqetësimin se dezinformatat<sup>7</sup> në lidhje me COVID-19 mund të vënë në rrezik efikasitetin e përballjes me këtë epidemi.<sup>8</sup>

Disa nga mitet që qarkullojnë në internet dhe në publik përfshijnë edhe sajesa, sipas të cilave përdorimi i tharëseve të duarve, ngrënia e hudhrave, dhe pirja e zbardhuesit të rrobave mund të kurojë infektimin; se shpërthimi i epidemisë ka ardhur si rezultat i zhvillimit të armëve biologjike nga Amerika apo Kina; se epidemia është një komplot i Fondacionit Bill & Melinda Gates; dhe se gjatë një episodi të filmit vizatimor The Simpsons, të transmetuar në vitin 1993, ishte përmendur emri i koronavirusit.<sup>9</sup> Dezinformata të tjera që hasen dendur kanë të bëjnë me ekzagjerimin e shifrave të personave të infektuar, si dhe portretizime të pasakta të politikave qeveritare. Studiuesit kanë arritur në përfundimin se informatat e rreme mbi COVID-19 janë përhapur shumë më gjerësisht se informacioni i përçar nga burime të specializuara si OBSh dhe Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve.<sup>10</sup>

Shpërthimi i epidemisë COVID-19 ka ndezur ndjenjat anti-kineze dhe kundër të huajve në shumë vende të botës, gjë që

ka çuar në shtimin e ndjeshëm të 'gjuhës së urrejtjes'. Kjo bie në sy në radhë të parë në platformat e mediave sociale, dhe nganjëherë këto materiale shpërndahen nga llogari anonime. Sidoqoftë, nganjëherë dhe mediat tradicionale dhe zyrtarë publikë janë bërë përçuese të mesazheve diskriminuese, dhe madje ka patur edhe raportime mbi biznese që vendosnin shenja që ndalonin hyrjen e klientëve kinezë.<sup>11</sup>

Shumë qeveri janë kundërpërgjigjur në mënyrë shumë të ashpër kundrejt dezinformatave në lidhje me shpërthimin e COVID-19. Ndonëse Kina e ka përmirësuar qasjen e saj ndaj epidemisë, duke zbatuar karantinë të rreptë dhe bashkëpunim të ngushtë me institucionet ndërkombëtare të shëndetit, shteti kinez vazhdon të kontrollojë nga afër narrativat në media dhe të sulmojë të gjithë ata që kritikojnë zyrtarë dhe politika qeveritare. Në vende të tjera në Azi, qeveritë kanë miratuar dhe vënë në zbatim ligje shtypëse kundër lajmeve të rreme, komunikimeve online, dhe krimeve kibernetike, duke arrestuar dhe duke ngritur akuza kundër atyre që presupozohet se përhapin pasaktësi dhe gënjeshtër mbi virusin<sup>12</sup>. Tajlanda ka ngritur Qendrën Kundër Lajmeve të Rreme për të hetuar mbi shpërndarjen e informatave të rreme në lidhje me COVID-19, dhe për të ngritur akuza penale kundër shkelësve<sup>13</sup>. Po kështu, qeveria e Iranit ka ngritur një 'qendër mbrojtjeje anti-koronavirus' që ka sjellë edhe arrestimin e disa individëve, që presupozohet se shpërndanin dezinformata, ndërkohë që autoritetet e vendit vazhdojnë të fshehin informacionin mbi përhapjen e COVID-19 në atë vend.<sup>14</sup>

Ka patur edhe nisma pozitive në përballjen me problemet që u përmendën më lart. Në muajin janar, OBSH krijoi Rrjetin e Informacionit për Epidemitë (EPI-WIN) për të luftuar keqinformimin e publikut duke shpërndarë sa më shpejt informacione të sakta nga burime të besueshme<sup>15</sup>. Po kështu OBSH po bashkëpunon me kompani të teknologjisë

së komunikimit si Facebook, Google, Tencent, Baidu, Twitter, TikTok, Weibo, Pinterest, si dhe personazhe interneti me influencë, për të promovuar përhapjen e informacioneve të sakta mbi COVID-19.<sup>16</sup> Platformat kryesore të mediave sociale kanë ndërmarrë hapa për të promovuar informacione mbi virusin nga burime të besueshme e të specializuara në materialet mediatike për përdoruesit e tyre, dhe po mundohen të vështirësojnë rënien në kontakt me dezinformata.<sup>17</sup>

ARTIKULLI 19 i mbështet këto nisma. Paralelisht me të drejta të tjera themelore të njeriut, e drejta e lirisë së shprehjes dhe informacionit duhet të shërbejë si bazë ligjore në përballjen me epideminë COVID-19. Në kushtet e një krize të shëndetit publik, siç është edhe shpërthimi i COVID-19, rrjedha e lirë e informacionit ka rëndësi të dorës së parë. Epidemitë dhe pandemitë virale, për nga vetë natyra e tyre, prekin masa të mëdha njerëzish, dhe ndikojnë mbi popullata të tëra në nivel kombëtar, rajonal, dhe botëror. Autoritetet shtetërore nuk mund të monitorojnë plotësisht, në kohë reale, përhapjen e virusit dhe identifikimin e vatrave të reja të infektimit. Për pasojë, një përgjigje e efektshme ndaj epidemive dhe pandemive nga ana e institucioneve të shëndetit publik është e lidhur ngushtë me monitorimin dhe raportimin nga publiku i gjerë të situatës në terren. Po kështu, edhe gazetarët, studiuesit dhe punonjësit e shëndetit publik luajnë një rol shumë të rëndësishëm në gjurmimin e përhapjes së virusit.

Nga ana tjetër, individë si doktorë dhe epidemiologë nuk mund të mbrojnë në mënyrë të efektshme veten dhe të tjerët pa patur akses në informacion të saktë dhe të përditësuar nga autoritetet. Refuzime dhe kufizime të informacionit nga ana e autoriteteve mundësojnë shpërthimin e epidemive me gënjeshtra.<sup>18</sup> Institucionet shtetërore kanë akses të drejtpërdrejtë në informacionin e mbledhur nga punonjës të administratës publike, dhe ndodhen në pozitën më të mirë për

të përpiluar informacionin që vjen njëherësh nga disa burime të dhënash, nga institucione shtetërore dhe jo-shtetërore. Aksesit në këtë informacion ka rëndësi themelore për të informuar dhe orientuar sjelljen e individëve, komuniteteve, dhe punonjësve të shëndetit publik. Nga ana tjetër, edhe publiku ka nevojë që të ketë akses në informacione mbi politika dhe aktivitete të institucioneve shtetërore, në mënyrë që të analizojë dhe vlerësojë reagimin e autoriteteve ndaj krizave të shëndetit publik.

Ky material paraqet qëndrimin e ARTIKULLIT 19 mbi çështje të lirisë së shprehjes që preken nga kriza COVID-19. Në të përshkruhen standardet ndërkombëtare mbi të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informacionit, veçanërisht në lidhje me të drejtën për shëndet. Materiali vë në dukje rolin kryesor që luajnë këto të drejta në raport me hartimin dhe zbatimin e strategjive të efektshme të shëndetit publik. Ky material udhëzues analizon me hollësi sfidat me të cilat përballet liria e shprehjes dhe informacionit gjatë kësaj krize të COVID-19, dhe jep disa rekomandime për institucionet shtetërore dhe aktorë të tjerë, veçanërisht mediat dhe platformat e mediave sociale

## Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

---

### E drejta e lirisë së shprehjes dhe të informacionit

E drejta e lirisë së shprehjes mbrohet nga neni 19 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (UDHR)<sup>19</sup>, dhe i atribuohet mbrojtje ligjore nga neni 19 i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)<sup>20</sup> si dhe nga traktate rajonale mbi të drejtat e njeriut.<sup>21</sup>

E drejta e lirisë së shprehjes mbulon një fushë të gjerë. Neni 19 (2) i ICCPR kërkon nga shtetet që t'u garantojnë të gjithë shtetasve të tyre të drejtën për të kërkuar, marrë dhe shkëmbyer informacione dhe ide të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, si gojarisht apo me shkrim, në shtyp apo në formë artistike, apo nëpërmjet çfarëdolloj media që kanë zgjedhur<sup>22</sup>. Komiteti i OKB-së mbi të Drejtat e Njeriut (Komiteti DN), një organizëm i ngarkuar me interpretimin e ICCPR, ka konfirmuar se kjo e drejtë mbulon opinionet politike, gazetarinë, mësimdhënien, diskutimin e çështjeve mbi të drejtat e njeriut, opinionet personale dhe komunikime private, si dhe siguron mbrojtje për shprehjen në internet.<sup>23</sup>

Ndonëse liria e shprehjes është një e drejtë themelore, ajo nuk është një e drejtë absolute. Shtetet mund të vendosin kufizime mbi këtë të drejtë për të mbrojtur interesa legjitime shtetërore, duke përfshirë edhe shëndetin publik. Sidoqoftë, Komiteti DN ka bërë të qartë se këto kufizime duhet të jenë masa që merren në raste të jashtëzakonshme dhe duhet të përmbushin tre kushte – testin me tri pika.<sup>24</sup> Çdo lloj kufizimi mbi këtë të drejtë duhet që të jetë:

- **I parashikuar në ligj:** kufizimet duhet të hyjnë në fuqi nëpërmjet miratimit të një ligji apo rregulloreje të

qartë dhe të hollësishme në mënyrë që individët të kenë mundësi që të përshtaten me kushtet e reja;

- **T'i shërbejë një qëllimi legjitim:** çdo lloj kufizimi i vendosur mbi këtë të drejtë duhet të përligjet me një nga interesat shtetërore të renditur në Nenin 19(3): respektimi i të drejtave dhe reputacionit të të tjerëve, mbrojtja e sigurisë kombëtare, rendit publik, apo shëndetit dhe moralit publik;
- **E nevojshme dhe proporcionale:** shteti duhet të demonstrojë në mënyrë specifike dhe rast pas rasti kërcënimin që i kanoset shoqërisë, si dhe nevojën dhe proporcionalitetin e masave që do të merren. Shteti duhet të provojë se ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis shprehjes dhe kërcënimit që i vjen shoqërisë.

Gjithashtu, Neni 20(2) i ICCPR thotë se çdo nxitje e urrejtjes mbi baza kombësie, racore apo fetare që mbështet apo promovon diskriminim, armiqësi apo dhunë duhet të ndalohej me ligj.

Përpara se të vendosin kufizime mbi lirinë e shprehjes, qeveritë duhet të demonstrojnë qartësisht kërcënimin që mendohet se i kanoset shëndetit publik, apo ndonjë interesi tjetër legjitim shtetëror,<sup>25</sup> si dhe nevojën dhe proporcionalitetin e metodave që kanë zgjedhur për kufizimin e lirisë së shprehjes.<sup>26</sup> Komiteti DN ka ngritur shqetësimin në lidhje me përdorimin e dispozitave penale kundër gazetarëve, studiuesve, dhe aktivistëve të të drejtave të njeriut gjatë shkëmbimit të informacioneve me interes legjitim publik.<sup>27</sup>

Krizat e shëndetit publik, si rastet e epidemive apo pandemive virale, shpesh sjellin në qendër të vëmendjes së publikut punën dhe aktivitetet e politikëbërësve. Gjatë shpërthimit të epidemisë COVID-19, frika dhe shqetësimet e publikut manifestoheshin herë pas here me kritika, herë të bazuara dhe herë të pabazuara, ndaj zyrtarëve shtetërorë dhe politikave

qeveritare. Sidoqoftë, përpjekjet nga ana e shtetit për të mbytur kritikën ndaj autoriteteve publike bien ndesh me respektimin e të drejtës për lirinë e shprehjes. Komiteti DN ka deklaruar se në rastet e debateve publike lidhur me figurat publike liria e shprehjes merr një vlerë edhe më të madhe.<sup>28</sup>

Edhe e drejta e aksesit në informacion është një nga përbërësit themelorë të së drejtës së lirisë së shprehjes. Veçanërisht publiku ka të drejtë që të marrë informacion të mbledhur nga institucionet publike.<sup>29</sup> Komiteti DN i rekomandon shteteve që të publikojnë paraprakisht informacione me interes publik, dhe të ndërmarrin hapa për të lehtësuar aksesin në informacione të mbledhura nga institucione publike, duke përfshirë edhe miratimin e ligjeve për garantimin e lirisë së informimit.<sup>30</sup> E drejta e aksesit në informacion mbulon të gjitha institucionet dhe autoritetet publike, duke përfshirë degët e pushtetit ekzekutiv, legjislativ, dhe juridik, në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.<sup>31</sup> Kjo e drejtë zbatohet edhe mbi informacionet e mbledhura nga institucione të tjera që kryejnë funksione publike.<sup>32</sup> Kufizime mund të vendosen edhe mbi të drejtën e aksesit në informacion, ndonëse është pjesë e rëndësishme e lirisë së shprehjes, por duhet të respektohen të njëjtat kritere strikte të parashikuara nga neni 19(3) i ICCPR.

## Legjislacioni i medias

Garantimi i lirisë së shprehjes aplikohet veçanërisht me forcë nga media. Organizatat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kanë nënvizuar vazhdimisht “rolin e rëndësishëm që luan shtypi në një shtet ku mbizotëron forca e ligjit”<sup>33</sup> dhe rolin thelbësor që luan media në një shoqëri demokratike.<sup>34</sup> Për shembull, Komiteti DN thekson se:

Komunikimi i lirë i informacioneve dhe ideve për çështje publike dhe politike midis qytetarëve, kandidatëve dhe



përfaqësuesve të zgjedhur nga populli është me rëndësi themelore. Kjo do të thotë se shtypi i lirë dhe media të tjera duhet të jenë në gjendje që të shprehin opinionin e tyre mbi çështje me interes publik pa censurë apo pengesa, dhe të informojnë opinionin publik. Po kështu, publiku duhet të gëzojë të drejtën për të patur akses ndaj materialeve të prodhuara nga media.<sup>35</sup>

Raportuesi Special për të drejtën e shëndetit ka theksuar veçanërisht rëndësinë e rolit të medias në përgjegjshmërinë dhe dhënien e llogarisë nga ana e sistemit të kujdesit shëndetësor.<sup>36</sup>

Ndërkohë që legjislacioni botëror mbi të drejtat e njeriut kërkon nga qeveritë e shteteve që të mbrojnë, promovojnë dhe respektojnë të drejtat e njeriut, pranohet gjerësisht se edhe kompanitë dhe bizneset private duhet të luajnë rolin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.<sup>37</sup> Parimet Bazë të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut është një dokument këshillues në lidhje me zbatimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në kompani private, duke përfshirë edhe kompanitë e mediave sociale.<sup>38</sup> Dokumenti i Parimeve Bazë thekson se bizneset private duhet të respektojnë të drejtat e njeriut<sup>39</sup> dhe rendit një sërë detyrash për këto kompani. Disa nga këto detyra janë respektimi i standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut,<sup>40</sup> zbutja e pasojave negative mbi të drejtat e njeriut,<sup>41</sup> hartimi i politikave për promovimin e të drejtave të njeriut,<sup>42</sup> kujdesi për identifikimin e kërcënimeve ndaj të drejtave të njeriut,<sup>43</sup> si dhe të mundësojnë ndreqjen e pasojave të shkaktuara nga shkeljet e të drejtave të njeriut.<sup>44</sup>

Duke patur parasysh pushtetin e platformave të mediave sociale në administrimin apo kufizimin e lirisë së shprehjes në internet, respektimi i standardeve të të drejtave të njeriut në lidhje me lirinë e shprehjes fiton një rëndësi të veçantë. Në një sërë dokumentesh, Raportuesi Special i OKB-së mbi lirinë e shprehjes dhe aksesit në informacion ka analizuar sjelljen

dhe punën e kompanive të mediave sociale në këtë drejtim. Ai ka ngritur shpesh shqetësimin se “janë të pakta ato kompani që i respektojnë parimet e të drejtave të njeriut gjatë punës së tyre”<sup>45</sup>, dhe se këto kompani i trajtojnë çështjet problematike, si gjuha e urrejtjes, “duke injoruar thuajse plotësisht ndikimin e produkteve të tyre mbi të drejtat e njeriut”.<sup>46</sup>

Politikat e moderimit të materialeve të publikuara në internet duhet të jenë të shprehura qartë dhe lehtësisht të kuptueshme nga të gjithë, në mënyrë që përdoruesit ta kenë të qartë që në fillim se si do të vlerësohet materiali i publikuar prej tyre në internet.<sup>47</sup> Në një raport të vitit 2018, Raportuesi Special shprehu shqetësimin e tij në lidhje me rregullat “subjektive” dhe “të paqarta” për moderimin online që zbatohen nga kompanitë e mediave sociale.<sup>48</sup> Po kështu, kompanitë e mediave sociale duhet që të sigurojnë të paktën një nivel elementar garancish për respektimin e të drejtave të përdoruesve, duke përfshirë njoftimin paraprak, dhënien e arsyeve për heqjen e materialit nga faqja, dhe krijimin e mundësive për apelim.<sup>49</sup>

## **E drejta e shëndetit**

E drejta për shëndet është përfshirë në UDHR<sup>50</sup> dhe ka fituar forcë ligjore nëpërmjet nenit 12 të Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights - ICESCR), e cila ndër të tjera i ngarkon shtetet nënshkruese me detyrën që të parandalojnë, trajtojnë, dhe të mbajnë nën kontroll epidemitë.<sup>51</sup> Konventa shprehet gjithashtu edhe në lidhje me përpjekjet individuale dhe të përbashkëta të shteteve për përdorimin dhe përmirësimin e mbikëqyrjes epidemiologjike dhe mbledhjen e të dhënave mbi sëmundjet.<sup>52</sup> Ajo thotë gjithashtu se aksesin në informacion përfshin edhe të drejtën për të kërkuar, marrë dhe shkëmbyer informacione dhe ide mbi çështje të shëndetit.

Shtetet duhet të respektojnë në të njëjtin nivel të drejtën e informimit edhe gjatë periudhës së epidemive.

E drejta për shëndet është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me lirinë e shprehjes dhe informacionit.<sup>53</sup> Komiteti i OKB-së mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore thekson se “nivelit i aksesit në informacion” është një nga elementët kryesorë të së drejtës për shëndet.<sup>54</sup> Kur shteti vendos kufizime mbi shprehjen dhe informacionin për çështje të shëndetit, dhe nuk publikon në mënyrë proaktive informacione shëndetësore, atëherë shëndeti i popullsisë vuan pasoja negative, dhe individit nuk e gëzon plotësisht të drejtën për shëndet.

Komiteti mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore bën thirrje kundër vendosjes së censurës mbi informacione që lidhen me shëndetin, apo marrjes së masave të tjera për parandalimin e pjesëmarrjes së publikut në diskutime dhe nisma të lidhura me shëndetin publik.<sup>55</sup> Ashtu si u pa edhe gjatë ndërhyrjes së qeverisë kineze në çastet e para të shpërthimit të epidemisë, bllokimi i raportimit nga ana e publikut pengon përpjekjet për monitorimin dhe zgjidhjen e situatës. Nga ana tjetër, mbrojtja e lirisë së shprehjes siguron që informacione me rëndësi jetike që mblidhen nga publiku i gjerë, gazetarë, dhe punonjës të shëndetit publik do të arrijnë te politikëbërësit dhe palët e interesuara.

Raportuesi Special mbi të drejtën për shëndet thekson edhe nevojën për transparencë në politikat e shëndetit publik, dhe rolin e rëndësishëm të informacionit në lidhje me kërkesën e llogarisë ndaj politikëbërësve dhe fuqizimin e rolit të individëve në mbrojtjen e shëndetit të tyre.<sup>56</sup> Po kështu, edhe Komiteti mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dënon “bllokimin apo shtrembërimin e qëllimshëm të informacioneve me rëndësi jetike për mbrojtjen apo përmirësimin e shëndetit.”<sup>57</sup>

## Sfidat ndaj lirisë së shprehjes si pasojë e COVID-19

---

### Keqinformimi dhe COVID-19

Keqinformimi është një problem serioz në situata të epidemive virale apo kriza të tjera që lidhen me shëndetin publik. Gjatë shpërthimit të COVID-19, shumë individë anembanë botës e kishin të vështirë të dallonin faktet nga trillimet. Disa prej tyre besonin në teori apo metoda që i shtonin rreziqet ndaj shëndetit, në vend që t'i mbronin nga infektimi. Qeveritë kanë të drejtë që e marrin seriozisht problemin e keqinformimit. Ato duhet të hartojnë politika që të ndalojnë në mënyrë të efektshme përhapjen e miteve dhe trillimeve, dhe t'u kundërvihen fushatave të qëllimshme të keqinformimit. Dezinformatat jo vetëm që pengojnë përpjekjet për mbrojtjen e shëndetit publik, por mund të shkaktojnë edhe shkelje të të drejtave të njeriut.

Pavarësisht rrezikut që i kanoset shoqërisë nga dezinformatat, çdollojkufizimimbishpërndarjeneinformacioneveqëmendohet se janë të rreme duhet të respektojë normat e ligjshmërisë, legjitimitetit, domosdoshmërisë, dhe proporcionalitetit që u përmendën më lart. Në lidhje me vlerësimin e këtyre kriterëve, duhet përmendur se e drejta e lirisë së shprehjes nuk mbulon vetëm deklaratat apo informacione të vërteta.<sup>58</sup> Në fakt, edhe deklaratat apo raportime të pavërteta mund të gëzojnë mbrojtje në kuadër të së drejtës së lirisë së shprehjes.

Deklarata e Përbashkët e vitit 2017 nga katër raportues të lirisë së shprehjes rendit një sërë sugjerimesh dhe këshillash që janë të vlefshme për qeveritë në kuadër të përpjekjeve kundër epidemisë COVID-19.<sup>59</sup> Raportuesit Specialë tërhoqën vëmendjen në Deklaratën e Përbashkët se:

Kufizime të përgjithshme mbi shpërndarjen e informacionit, bazuar mbi rregulla dhe përkufizime të paqarta dhe konfuze, si “lajme të rreme” apo “informacion jo-objektiv,” bien ndesh me standardet ndërkombëtare.<sup>60</sup>

Për fat të keq, qeveri anembanë botës kanë përdorur pikërisht këtë lloj ndërhyrje represive dhe kanë miratuar ligje shumë të përgjithshme për të goditur ato që supozohen se janë dezinformata mbi koronavirusin. ARTIKULLI 19 ka ngritur vazhdimisht shqetësimin se shumë nga këto ligje<sup>61</sup> dhe hapësirat e gjera që i japin autoriteteve për të kufizuar lirinë e fjalës, shpesh degjenerojnë në zbatime arbitrare të këtyre normave të reja ligjore, dhe nuk i japin mundësi individëve që të orientohen dhe të përshtatin aktivitetin e tyre duke respektuar normat ligjore.<sup>62</sup>

Po kështu, aksionet qeveritare anti-keqinformim që mbështeten kryesisht te censura, ndëshkimet penale, dhe dënimet me burg janë burim shqetësimi në lidhje me shkeljen e parimit të proporcionalitetit.

Ashtu si u përshkrua edhe më lart, disa qeveri, veçanërisht Kina, kanë përdorur gjerësisht censurën mbi informacionet rreth COVID-19 pa u siguruar më parë se mjaftonte zbatimi i metodave të tjera më pak agresive. Për më tepër, shumë shtete kanë vënë nën shënjestër persona që presupozohet se shpërndanin dezinformata, duke përdorur ligje që parashikojnë dënime të rënda penale, duke përfshirë edhe burgimin. ARTIKULLI 19 sugjeron se dënimet me burg mund të jenë proporcionalisht të pranueshme vetëm për krimet më të rënda që lidhen me shprehjen, si në rastet e gjuhës së urrejtjes diskriminuese që cilësohet edhe si nxitje dhune.<sup>63</sup>

Po kështu, ka edhe arsye të forta në mbështetje të politikave publike për të evituar ndërhyrje agresive në luftën kundër keqinformimit gjatë epidemive apo pandemive. Është e

domosdoshme që individi të ndiejë se është i lirë që të shprehë shqetësimin e tij në lidhje me përhapjen e COVID-19 apo ndërhyrjen e qeverisë, pa patur frikë nga ndëshkimet, edhe nëse del se shqetësimet e tyre janë pa vend. Ndëshkimi i qytetarëve për shpërndarjen e paqëllimshme të informacioneve të rreme mund të dëmtojë rëndë komunikimin në shoqëri, duke penguar shkëmbimin e informacioneve të nevojshme për identifikimin dhe luftimin e epidemive virale. Ndërhyrjet tepër agresive kundër dezinformatave dekurajojnë raportimin e informacioneve nga ana e publikut që mund të ndihmojnë në identifikimin e shpejtë dhe zbutjen e pasojave.

Për fat të keq, përveç angazhimit të metodave agresive kundër dezinformatave, në shkelje të ligjit ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, edhe vetë disa shtete kanë përhapur dezinformata dhe propagandë.<sup>64</sup> Gjatë një krize të shëndetit publik, programet dhe politikat qeveritare vëzhgohen dhe analizohen nga afër nga publiku, dhe në situata të tilla shtetet shpesh e ndiejnë të nevojshme të kontrollojnë narrativën dhe të ndikojnë mbi perceptimin e publikut ndaj punës së autoriteteve. Si qeveria amerikane ashtu edhe qeveria kineze janë akuzuar për portetizim të gabuar të përhapjes së COVID-19 dhe politikave të tyre për zgjidhjen e krizës.<sup>65</sup> Qeveri të tjera janë akuzuar për fshehjen e përhapjes së virusit<sup>66</sup> apo për shpërndarjen e informatave të rreme për përfitime politike. Keqinformimi shtetëror është veçanërisht i rrezikshëm, pasi dëmton besimin e publikut ndaj autoriteteve shtetërore, dhe mund të shkaktojë ndërhyrje të gabuara nga institucione shtetërore dhe punonjës të shëndetit publik.

### **‘Gjuha e urrejtjes’**

Nuk ka një përkufizim të veçantë mbi ‘gjuhën e urrejtjes’ që të pranohet gjerësisht në fushën e ligjit ndërkombëtar mbi të

drejtat e njeriut. Sidoqoftë, qeveritë, politikanët, dhe qytetarët e thjeshtë e përdorin nganjëherë këtë term për të përshkruar negativisht opinione që bien ndesh me mendimet e tyre, si dhe për të bërë thirrje që të vendosen kufizime mbi disa lloje shprehjesh.

Shfryrja e ndjenjave anti-kineze dhe anti-të huaj si pasojë e përhapjes së COVID-19 mund të rezultojë në cenimin e të drejtave të njeriut. ‘Gjuha e urrejtjes’ mund të shërbejë si nxitëse e dhunës dhe diskriminimit dhe mund të pengojë ushtrimin e të drejtave të njeriut nga grupe që janë bërë objekt sulmi. Por nga ana tjetër, ndërhyrjet tepër agresive kundër ‘gjuhës së urrejtjes’ mund të mbysin debatin publik dhe të cenojnë të drejtën e lirisë së shprehjes. Për pasojë, çdo kufizim nga ana e autoriteteve kundër ‘gjuhës së urrejtjes’ duhet të respektojë kriteret e parashikuara nga nenet 19(3) dhe 20(2) të ICCPR.

Ndonëse qeveritë mund të kenë herë pas here arsye legjitime për të vendosur kufizime mbi ‘gjuhën e urrejtjes’ – për shembull, për të promovuar shëndetin publik, apo për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve – ato shpesh veprojnë në mënyrë të gabuar, duke zbatuar ndëshkime penale në vend të masave të tjera më pak agresive. Legjislacioni civil dhe penal ofrojnë mundësi të shumta për të gjetur zgjidhje të efektshme dhe proporcionale ndaj ‘gjuhës së urrejtjes’. Ndëshkimet penale duhet të vendosen vetëm atëherë kur nuk ka mbetur më asnjë alternativë dhe vetëm në rastet më të rënda, dhe dënimet nuk duhet të jenë tepër të ashpra.<sup>67</sup>

Zbatimi i dëndur i ndëshkimeve penale shpesh shkakton injorimin dhe anashkalimin e zgjidhjeve të tjera më të efektshme kundër ‘gjuhës së urrejtjes’. Në disa dokumente, si Rezoluta e Këshillit për të Drejtat e Njeriut 16/1868 (Human Rights Council Resolution) dhe Plani i Veprimit të Rabatit<sup>69</sup> (Rabat Plan of Action), organizma të OKB-së kanë parashtruar sugjerime dhe këshilla mbi masa dhe politika pozitive që duhet

të ndërmerren nga shtetet për të luftuar diskriminimin dhe 'gjuhën e urrejtjes', duke përfshirë krijimin e mekanizmave zyrtare për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve shoqërore, trajnimin e zyrtarëve të qeverisë për promovimin e tolerancës, krijimin e hapësirave dhe mundësive që udhëheqës politikë apo shoqërorë të flasin kundër intolerancës, promovimin e dialogut të brendshëm në komunitete dhe midis tyre, promovimin e pluralizmit mediatic, dhe miratimin e ligjeve të forta kundër diskriminimit. Qeveritë duhet t'i përfshijnë këto masa në planet e tyre për të luftuar frymën anti-kineze dhe anti-të huaj, dhe 'gjuhën e urrejtjes' në vazhdën e COVID-19.

Edhe faktorë të tjerë jo-shtetërorë, duke përfshirë mediat, kompanitë e mediave sociale dhe publikun e gjerë duhet të luajnë rolin e tyre në luftën kundër 'gjuhës së urrejtjes' dhe intolerancës (më poshtë ka më shumë informacion mbi këtë çështje). OBSH ka bashkuar forcat me UNICEF dhe Federatën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq në hartimin e udhëzimeve për qeveritë, mediat dhe shoqërinë civile për të luftuar damkën sociale që lidhet me COVID-19.<sup>70</sup>



## Përgjigje e efektshme ndaj shpërthimit të COVID-19: roli i lirisë së shprehjes dhe informacionit

---

### Rrjedha e lirë e informacionit

Informacioni luan një rol të dorës së parë në formulimin e një përgjigjeje të efektshme ndaj COVID-19, duke përfshirë edhe zbatimin e masave mbrojtëse për publikun. Për këtë arsye, një nga hapat kryesore në zbatimin e strategjive për zgjidhjen e krizave të shëndetit publik duhet të jetë identifikimi i informacioneve me rëndësi thelbësore për popullatën, komunitetet, dhe individët. Duhet të merret në konsideratë jo vetëm se çfarë informacionesh duhen publikuar, por edhe mënyrat e paraqitjes së tyre për publikun, në mënyrë që të gjenden lehtësisht dhe të jenë të kuptueshme nga audienca të ndryshme.

Refuzimi i aksesit në informacion vjen kryesisht nga mungesa e legjislacionit mbi lirinë e informimit dhe mendësia e fshehtësisë institucionale nga një numër i madh autoritetesh shtetërore. Po kështu, në shumë vende legjislacioni represiv pengon aksesin dhe qarkullimin e informacioneve me rëndësi jetike për publikun. Liria e informacionit nuk përmendet shpesh si element me rëndësi për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut.

### Roli i medias

Një media e lirë dhe e pavarur luan një rol veçanërisht të rëndësishëm gjatë një krize të shëndetit publik, si shpërthimi i epidemisë COVID-19. Media luan rol të dorës së parë në përçimin e informacioneve tek individë që ka të ngjarë të

preken nga kriza. Një media e lirë dhe e pavarur mund të monitorojë përgjigjet kombëtare dhe ndërkombëtare ndaj shpërthimit të epidemisë dhe të promovojë transparencë dhe përgjegjësi në zbatimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik. Gjithashtu media mund të përçojë mesazhe të rëndësishme edhe nga publiku i prekur nga kriza drejt politikëbërësve dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm.

Që nga momenti i parë i raportimit të shfaqjes së COVID-19 në Kinë gazetarët kanë luajtur një rol kyç në përpjekjet për të reduktuar rreziqet e lidhura me virusin. Ata kanë identifikuar vatra të reja të shpërthimit të epidemisë, kanë dhënë informacion mbi masat mbrojtëse, kanë demaskuar informacione të rreme, dhe kanë kërkuar llogari nga qeveritë për politikën e tyre. Sidoqoftë, nganjëherë gazetarët kanë dështuar në respektimin e standardeve të larta profesionale, duke raportuar në mënyrë të pasaktë, apo edhe duke i bërë jehonë narrativave dhe mesazheve diskriminuese.

Sulmet kundër gazetarëve nga ana e qeverive dobësojnë aftësitë e vetë autoriteteve shtetërore për t'iu përgjigjur krizës së COVID-19. Arrestimet, apo ngritja e akuzave penale kundër gazetarëve që raportojnë në lidhje me virusin, ashtu si njoftohet nga disa vende,<sup>71</sup> janë shembuj të shkeljeve të rënda nga ana e autoriteteve shtetërore. Sidoqoftë, edhe forma të tjera më të buta ngacmimi apo frikësimi, siurvejimi agresiv, apo refuzimi dhe mosrindovimi arbitrar i vizave janë akte të dëmshme dhe kundërproduktive.

Mediat tradicionale luajnë një rol të pazëvendësueshëm në përballimin e krizave të shëndetit publik, si në rastin e shpërthimit të COVID-19. Raportimi korrekt, i bazuar mbi fakte, nga ana e gazetarëve mund të demaskojë dhe hedhë poshtë mite e trillime, të zbërthejë fushata propagande, dhe të luftojë 'gjuhën e urrejtjes'. Nga ana tjetër, raportimi i pasaktë,

diskriminues, apo informata që kanë për qëllim të mashtrojnë publiku, mund të shkaktojnë cikle keqinformimi dhe valë intolerance.

Respektimi i standardeve të etikës gazetareske ka rëndësi themelore në situata të tilla.<sup>72</sup> Gazetarët duhet t'i përmbahen standardeve më të larta profesionale në mënyrë që të sigurojnë informim të saktë dhe të besueshëm për publikun. Kompanitë mediatike duhet të sigurohen që standardet profesionale të njihen, të shkëmbehen midis kolegësh, dhe të promovohen nga të gjithë punonjësit e tyre. Po kështu, strukturat e brendshme të këtyre kompanive duhet që të mbështesin gazetarët në identifikimin dhe diskutimin e çështjeve që kanë të bëjnë me këto standarde. Institucionet rregullatorë të medias duhet të mbështesin dhe të promovojnë standarde të larta profesionale, të lejojnë hapësira për vërejtje dhe ankesa nga publiku, si dhe të krijojnë mundësi për ndreqjen e gabimeve, si e drejta e replikës apo korrigjimet.

Media luang gjithashtu një rol kyç në luftën kundër keqinformimit dhe 'gjuhës së urrejtjes' duke promovuar mosdiskriminimin dhe mirëkuptimin ndërkulturor në periudha krizash.<sup>73</sup> Në rastet kur përhapen dezinformata, media, veçanërisht organet publike të medias, mund të luajnë rol të rëndësishëm në identifikimin dhe përgënjeshttrimin e informatave të rreme. Ndër të tjera, gazetarët duhet të raportojnë në mënyrë të saktë, të shmangin stereotipat negativë, të mos përmendin domosdoshmërisht racën apo kombësinë e personave të prekur, si dhe duhet të raportojnë mbi akte diskriminimi.<sup>74</sup> Rregullatorët e medias duhet të hartojnë rekomandime të hollësishme, bazuar mbi standardet profesionale, se si duhet të trajtohen nga ana e gazetarëve çështjet e keqinformimit, 'gjuhës së urrejtjes', dhe diskriminimit.

## Roli i mediave sociale

Platformat e mediave sociale po luajnë një rol gjithnjë e më dominues në fushën e komunikimit, duke shpërndarë informacione dhe duke shkëmbyer opinione. Platformat dominuese si Facebook, Twitter, YouTube, Weibo, e të tjera, mund të përdoren në të mirë të interesit publik, por mund të përdoren edhe për të mbjellë kaos dhe mosbesim. Këto alternativa dolën qartë në pah gjatë përdorimit të mediave sociale gjatë shpërthimit të COVID-19. Qeveritë, punonjës të shëndetit publik, komunitete dhe individë hynë rregullisht në platformat e mediave sociale për të marrë informacione thelbësore në lidhje me virusin. Sidoqoftë, ka patur edhe shumë raste konfuzioni dhe çorientimi si pasojë e informacioneve të shumëllojshme dhe kontradiktore të publikuara në internet.

Ndërkohë, aftësia e platformave të mediave sociale për të ushtruar censurë tashmë rivalizon, madje, në disa raste, ka tejkaluar edhe pushtetin e ushtruar nga qeveritë. Sidoqoftë, edhe ato duhet të respektojnë të njëjtat standarde ndërkombëtare si qeveritë, madje një numër i vogël i tyre kanë ndërthurur standardet e të drejtave të njeriut në politikat dhe veprimtarinë e tyre.

Platformat e mediave sociale duhet të sigurojnë që çdo veprim ndëshkues kundër përmbajtjes ose përdoruesve të jetë transparent dhe i shpjeguar qartë në rregulloren e anëtarësimit dhe përdorimit. Ato kanë më shumë mundësi dhe alternativa sesa qeveritë që t'u kundërvihen dezinformative, duke patur në dispozicion mundësi të shumta për ndërhyrje fleksibël që respektojnë Parimet Bazë.<sup>75</sup> Përpara se të arrijnë te përjashtimi i përdoruesve apo heqjes së materialeve të pasakta, kompanitë e mediave sociale mund të modifikojnë algoritmet e tyre për të promovuar materiale nga burime të besueshme, të kufizojnë përhapjen virale, të vendosin shenja dhe njoftime për përmbajtje të pavërteta, të zbatojnë në mënyrë strikte politikat

reklamuese, të pezullojnë përkohësisht llogari të caktuara, apo të vendosin link për burime të besueshme informacioni.<sup>76</sup>

Edhe partneriteti midis kompanive të mediave sociale dhe organizmave të tjerë mund të ofrojë mundësi për të luftuar keqinformimin dhe 'gjuhën e urrejtjes'. Ashtu si u përmend edhe më lart, për shembull, Facebook bashkëpunon me OBSH-në dhe ministri të shëndetësisë duke promovuar linqe drejt faqeve me përmbajtje të besueshme mediatike.<sup>77</sup> Facebook bashkëpunon gjithashtu edhe me kontrollues faktesh të pavarur për të luftuar dezinformatat mbi virusin. Bashkëpunime dhe nisma të tilla mbështeten dhe nxiten nga Raportuesi Special i OKB-së mbi lirinë e shprehjes dhe aksesit në informacion, nga raportues rajonalë, dhe faktorë të tjerë.<sup>78</sup> Sidoqoftë, bashkëpunime që bëjnë të mundur heqjen e materialeve nga faqet, apo veprime të tjera ndëshkuese kundër fjalës dhe shprehjes në internet mund të kufizojnë në mënyrë të papërligjur lirinë e shprehjes. Platformat e mediave sociale duhet të jenë transparente në lidhje me bashkëpunimet e tyre me elementë të tjerë dhe të sigurohen se këto angazhime shërbejnë për përforcimin e standardeve ndërkombëtare në lidhje me lirinë e shprehjes.

Qeveritë kanë kërkuar vazhdimisht që të ushtrojnë ndikim mbi mënyrën se si kompanitë e mediave sociale administrojnë publikimin e informacioneve dhe shprehjen e opinioneve në platformat e tyre – si nëpërmjet miratimit të dispozitave ligjore, kërkesave të bëra privatisht, ose nëpërmjet kërcënimeve për të mbyllur aksesin në këto platforma. Disa nga kërkesat e qeverive, nëse do të pranoheshin, do të rezultonin në shkelje të të drejtave të njeriut, si kërkesa të papërligjura për dhënien e informacioneve personale të përdoruesve, apo urdhra për të censuruar kritikën ndaj zyrtarëve publikë. Ashtu si përshkruhet te Parimet Bazë, bizneset duhet të "gjejnë mënyra për të respektuar parimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kur përballen me kërkesa kontradiktore."<sup>79</sup>

Ndonëse rregullimi me ligj i funksionimit të platformave të mediave sociale nuk është domosdoshmërisht i papërputhshëm me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ai duhet të kryhet në mënyrë të tillë që të garantojë lirinë e shprehjes. Parimet e Manilas mbi Përgjegjësinë e Palëve Ndërmjetëse (Manila Principles on Intermediary Liability) përcakton standardet që duhen ndjekur në marrëdhëniet midis qeverive dhe platformave online.<sup>80</sup> Një nga pikat kryesore të këtij dokumenti është parimi se palët ndërmjetëse nuk duhet të mbajnë përgjegjësi për materialet e publikuara nga palët e treta.<sup>81</sup> Qeveritë duhet të abrogojnë apo të ndryshojnë ligjet që parashikojnë mbajtjen e përgjegjësive nga palët ndërmjetëse, dhe të mos miratojnë më ligje të kësaj natyre në të ardhmen.

Ç'është më e rëndësishme, platformat e mediave sociale duhet të sigurojnë transparencë në marrëdhëniet e tyre me qeveritë. Raportuesi Special ka bërë thirrje për bërjen publike të “informacionit mbi aktivitetet qeveritare që kryhen me ndihmën e kompanive private”<sup>82</sup>, dhe ka kritikuar ‘raportet e transparencës’ të publikuara nga kompanitë e mediave sociale për mangësi në raportim.<sup>83</sup>

Ashtu si u përshkrua edhe më lart, keqinformimi paraqet një kërcënim të madh për të drejtat e njeriut, dhe ndikon negativisht mbi përpjekjet për të ndaluar përhapjen e COVID-19. Qeveritë, mediat, dhe platformat e mediave sociale kanë rolet e tyre për të luajtur në përpjekjet kundër keqinformimit, por duhet të ndjekin politika që bazohen te respekti për të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informacionit.

## Rekomandime

---

Standardet dhe garancitë ndërkombëtare të të drejtave të njeriut duhet të respektohen përgjatë gjithë përpjekjeve për të luftuar COVID-19, duke përfshirë edhe të drejtën për të gëzuar lirinë e shprehjes dhe informacionit. ARTIKULLI 19 i bën thirrje shteteve, medias, dhe platformave të mediave sociale që të ndërmarrin masat e mëposhtme.

### Drejtuar shteteve

- Qeveritë duhet të **publikojnë në mënyrë proaktive informacione** mbi përhapjen e COVID-19, duke përfshirë numrin e rasteve, shpërndarjen gjeografike, statistikat mbi vdekshmërinë dhe shërimet, si dhe informacione mbi politikat qeveritare dhe punën në terren. Disa nga hapat e para në këtë drejtim përfshijnë fushata të ndërgjegjësimit publik, faqe interneti të krijuara posaçërisht dhe shpërndarje mesazhesh nëpërmjet mediave sociale me informacione të përditësuara mbi virusin, si dhe rekomandime në lidhje me strategjitë e parandalimit të përhapjes. Të gjitha politikat dhe planet e punës për kufizimin dhe ndalimin e përhapjes së COVID-19 duhet të përfshijnë përkushtimin ndaj transparencës dhe informimit të publikut.
- Qeveritë duhet të vënë në zbatim **ligje që garantojnë lirinë e informacionit** për të lehtësuar aksesin në informacione publike, duke përfshirë edhe miratimin e rregullave të reja për publikimin e informacioneve të caktuara, si dhe krijimin e një sistemi për të mundësuar kërkesat për informacione nga autoritetet publike nga ana e individëve apo grupeve. Ato shtete që kanë miratuar ligje

të lirisë së informimit duhet t'i japin përparësi zbatimit të këtyre ligjeve dhe përmirësimit të legjislacionit për t'i përfruar sa më shumë me standardet ndërkombëtare e rajonale, dhe me eksperiencat më të mira në këtë fushë. Shtetet e tjera duhet të marrin në konsideratë miratimin e ligjeve për lirinë e informimit nëpërmjet një procesi të hapur e gjithëpërfshirës.

- Autoritetet publike nuk duhet të **mbështeten te dënimet penale** dhe masa të tjera ndëshkuese si metoda kryesore për luftën kundër 'gjuhës së urrejtjes' dhe dezinformatave në lidhje me përhapjen e COVID-19. Procedimet penale dhe dënimet me burg duhet të rezervohen vetëm për rastet më të rënda të krimeve që vijnë nga fjala dhe shprehja. Përveç rasteve ekstreme që mund të hyjnë në këtë kategori, autoritetet duhet të **pezullojnë çështjet** ndaj të gjithë atyre personave që aktualisht po përballen me procedime penale si pasojë e publikimit të informacioneve dhe materialeve mbi virusin, dhe të lirohen nga burgu ata që janë dënuar në lidhje me akuza të tilla. Po kështu, qeveritë duhet të **vendosin moratorium për zbatimin e ligjeve represive** në lidhje me informacione mbi COVID-19. Duhet të fillojnë të marrin masa për të **përmirësuar legjislacionet** në mënyrë që të përshtaten me standardet ndërkombëtare të lirisë së shprehjes.
- Autoritetet publike duhet të marrin masa dhe të sigurohen që të **mos shpërndajnë dezinformata**, dhe qeveritë nuk duhet të ndër marrin fushata propagandistike apo keqinformuese.
- Qeveritë duhet të **garantojnë mbrojtje maksimale për denoncuesit e shkeljeve dhe korrupsionit**. Mbrojtja e denoncuesve përfshihet në legjislacionin e shumë shteteve si pjesë e ligjeve për lirinë e informimit, apo edhe



në ligje të veçanta. Këto shtete duhet të përqendrohen te zbatimi konsekuent i këtyre ligjeve për të mbrojtur ata që ngrenë zërin kundër shkeljeve apo abuzimeve nga ana e qeverisë, apo dështimeve të politikave të lidhura me COVID-19. Ato shtete që nuk kanë ligje të veçanta për mbrojtjen e denoncuesve nuk duhet të nisin procedime apo të vendosin kufizime mbi ata që publikojnë informacione me interes publik mbi COVID-19.

- Qeveritë duhet të **hartojnë politika pozitive për të luftuar 'gjuhën e urrejtjes'** dhe intolerancën, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe përvojat më të mira në këtë fushë. Rezoluta 16/18 e Këshillit mbi të Drejtat e Njeriut, dhe Plani i Punës i Rabatit japin udhëzime dhe këshilla të vlefshme në këtë drejtim.
- Qeveritë duhet të ndërmarrin hapa për të **siguruar një ambient mediatik të lirë, të pavarur, dhe të shumëllojshëm**, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të ligjeve dhe rregullave të qarta që garantojnë vetëqeverisjen dhe pavarësinë e medias dhe transmetimeve elektronike. Gjithashtu, shtetet duhet që të marrin në konsideratë mbështetjen dhe financimin e sektorit të pavarur të mediave publike, me qëllim që t'i shërbejnë interesit publik, duke përfshirë edhe raportimet mbi COVID-19 dhe kriza të tjera të ngjashme të shëndetit publik.
- Autoritetet shtetërore duhet **t'i japin fund ngacmimit dhe pengimit të gazetarëve** që raportojnë mbi COVID-19 dhe punës së qeverisë për ndaljen e përhapjes së virusit.
- Qeveritë duhet të planifikojnë marrjen e masave për të **promovuar përmirësimin e njohurive mbi mediat dhe teknologjinë digjitale** në përgjithësi, si dhe në

kuadër të shpërthimit të epidemisë COVID-19. Kjo mund të arrihet duke futur në shkolla lëndë apo orë mësimore mbi njohuritë e medias edhe teknologjisë digjitale, si dhe duke angazhuar shoqërinë civile dhe platformat e mediave sociale në këto përpjekje.

## Drejtuar medias

- Organet e medias dhe gazetarët duhet të **raportojnë në mënyrë aktive mbi raste të keqinformimit, propagandës dhe diskriminimit** nga ana e shtetit, apo nga elementë joshtetërorë, në kuadër të epidemisë COVID-19. Raportimi i saktë nga burime gazetareske me reputacion të mirë është arma më e fortë për të luftuar keqinformimin dhe 'gjuhën e urrejtjes'.
- Organet e medias dhe gazetarët duhet të **krijojnë dhe forcojnë sisteme të efektshme vetërregullimi**, duke përfshirë këtu këshilla kombëtare për ankesat mbi shtypin, si dhe përfaqësues të popullit apo redaktorë nga publiku të atashuar pranë organeve mediatike. Këto organizma apo zyrtarë **duhet të garantojnë respektimin e të drejtës së replikës dhe korrigjimit të gabimeve** për të ndrequr problemet e krijuara nga raportimi i pasaktë apo diskriminues në lidhje me COVID-19.
- Organet e medias dhe gazetarët duhet t'i **përmbahen standardeve më të larta etike, duke përfshirë edhe parimin e barazisë**, gjatë raportimit mbi COVID-19. Ata duhet të raportojnë mbi COVID-19 në mënyrë të saktë dhe pa paragjykime, duke shmangur stereotipat, dhe të mos përmendin domosdoshmërisht racën apo kombësinë e personave gjatë raportimit.

## Drejtuar platformave të mediave sociale

- Kompanitë e mediave sociale duhet të **hartojnë politika të qarta dhe të kuptueshme** në lidhje me keqinformimin dhe ‘gjuhën e urrejtjes’ në platformat e tyre, në përputhje me parimin “të drejtat e njeriut mbi të gjitha,” siç rekomandohet nga Raportuesi Special i OKB-së mbi lirinë e shprehjes. Shumë kompani i kanë rafinuar politikat dhe metodat e tyre të moderimit gjatë viteve të fundit, duke renditur përkufizime më të sakta, dhe shembuj të rasteve kur materiali shkel rregullat e platformës. Ato duhet ta thellojnë këtë proces, duke i bërë rregullat akoma më të qarta. Po kështu, hartimi i politikave dhe masave nga ana e kompanive të mediave sociale në kuadër të shpërthimit të epidemisë COVID-19 duhet të jenë të qarta dhe në përputhje me standardet ligjore që parashikohen nga legjislacioni ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut.
- Platformat e mediave sociale duhet të **garantojnë një minimum ligjshmërie** në marrjen e masave kundër ‘gjuhës së urrejtjes’ dhe keqinformimit mbi COVID-19. Ato duhet t’i njoftojnë përdoruesit e tyre për marrjen e masave ndëshkimore, si heqja e materialeve nga faqja, kufizimi i shikueshmërisë, apo bllokimi i faqes. Heqja e përmbajtjes nga faqja duhet të bëhet duke ndjekur procedura të qarta dhe transparente, pasi këtu kemi të bëjmë me një formë moderimi të përmbajtjes. Në të gjitha rastet, përdoruesit duhen të kenë mundësi reale për të apeluar vendimin e kompanive.
- Kompanitë e mediave sociale duhet të **sigurojnë transparencë të plotë në lidhje me bashkëpunimin e tyre me qeveritë** në lidhje me dezinformatat dhe COVID-19. Ky lloj informacioni duhet t’i bashkëngjitet raporteve periodike të transparencës, që duhet të jenë

më të plota dhe gjithëpërfshirëse. Po kështu, kompanitë duhet **t'i rezistojnë kërkesave të qeverive që shkelin të drejtat e njeriut.**

- Së fundmi, platformat e mediave sociale duhet që **të angazhohen në bashkëpunime për të luftuar 'gjuhën e urrejtjes' dhe dezinformatat** mbi COVID-19. Ato duhet që të vazhdojnë dhe thellojnë më tej bashkëpunimin me Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe ministritë e kujdesit shëndetësor anëmbanë botës për të promovuar shpërndarjen e informacioneve të sakta mbi virusin. Bashkëpunimi me kontrolluesit e pavarur të fakteve është një element premtues. Sidoqoftë, kompanitë duhet të sigurohen se këto lloj angazhimesh janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

## Shënime

---

- <sup>1</sup> Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), Emërtimi i sëmundjes koronavirus dhe virusit që e shkakton (Naming the coronavirus disease [COVID-19] and the virus that causes it).
- <sup>2</sup> OBSH, Koronavirusi i ri (COVID-19) Tablo e situatës.
- <sup>3</sup> Shiko p.sh., Li Yuan, Kina i mbyll gojën kritikëve në lidhje me shpërthimin e epidemisë virale (Li Yuan, China Silences Critics Over Deadly Virus Outbreak) New York Times, 22 Janar 2020; Human Rights Watch, Kina: Të respektohen të drejtat e njeriut në përpjekjet kundër koronavirusit (China: Respect Rights in Coronavirus Response), 30 Janar 2020.
- <sup>4</sup> Shiko p.sh., G. Shih, E. Rauhala & L.H. Sun, Gabimet e para dhe mbajtja sekret nga shteti në Kinë mund të ketë lejuar koronavirusin që të përhapet më shpejt dhe më larg (Early missteps and state secrecy in China probably allowed the coronavirus to spread farther and faster), Washington Post, 1 Shkurt 2020; Chris Buckley dhe Steven Lee Myers, Ndërkohë që koronavirusi po përhapej, zakonet e vjetra të Kinës vonuan kundërpërgjigjen (As New Coronavirus Spread, China's Old Habits Delayed Fight), New York Times, 1 Shkurt 2020.
- <sup>5</sup> Shiko p.sh. Li Yuan, keqardhje dhe zemërim në Kinë për vdekjen e doktorit të koronavirusit (Li Yuan, Widespread Outcry in China Over Death of Coronavirus Doctor), New York Times, 7 Shkurt 2020.
- <sup>6</sup> OBSH, Koronavirusi i ri (2019-nCoV) Raporti mbi situatën - 13, 2 Shkurt 2020 .
- <sup>7</sup> Në këtë material termi 'keqinformim' i referohet të gjitha informacioneve të pasakta apo çorientuese, duke bërë dallim nga dezinformimi, që është informacion i pasaktë që shpërndahet për qëllime të caktuara dashakeqe, për të mashtruar, çorientuar dhe manipuluar.
- <sup>8</sup> OBSH, konferencë shtypi e Drejtorit të Përgjithshëm mbi virusin e ri koronavirus të viti 2019, më 8 Shkurt 2020. Drejtori i Përgjithshëm tha se "gjatë përhapjes së virusit, dezinformatat e vështirësojnë

akoma më shumë punën e punonjësve heroikë të shëndetit publik. Po shpërqundrohet vëmendja e autoriteteve vendimmarrëse. Po shkakton edhe rrëmujë e panik në publikun e gjerë.”

- 9 Shiko p.sh., OBSH, Sëmundja e koronavirusit (COVID-19) këshilla për publikun: Hedhja poshtë e trillimeve; M. Richtel, OBSH po lufton edhe një pandemi tjetër përveç koronavirusit: një “Infodemi” (W.H.O. Fights a Pandemic Besides Coronavirus: an “Infodemic”) NewYork Times, 6 Shkurt 2020; E.J. Dickson, Koronavirusi po përpahet, dhe po kështu po përhapen trillimet dhe teoritë e konspiracionit (Coronavirus Is Spreading-And So Are the Hoaxes and Conspiracy Theories Around it), Rolling Stone, 2 Mars 2020.
- 10 J. Gregory, ‘Infodemia’ e koronavirusit ekziston me të vërtetë. Kemi krijuar një listë me faqet e internetit që janë përgjegjëse për këtë problem (The coronavirus ‘infodemic’ is real. We rated the websites responsible for it), 28 Shkurt 2020.
- 11 Shiko p.sh., H-J. Kim, Frika ndaj virusit të ri ndez ndjenjat anti-Kinë nëpër botë (Fears of new virus trigger anti-China sentiment worldwide), 2 Shkurt 2020.
- 12 Shiko p.sh., Amnesty International, Singapore: Kompanitë e mediave sociale detyrohen që të respektojnë ligje abuzive kundër lajmeve të rreme (Social media companies forced to cooperate with abusive fake news law), 19 Shkurt 2020. <https://www.amnesty.org/en/latest/news/2020/02/singapore-social-media-abusive-fake-news-law/>; M. Tostevin & J. Geddie, Koronavirusi mobilizon censurën e mediave sociale në Azi (Coronavirus sends Asia’s social media censors into overdrive), 4 Shkurt 2020; B.Schmidt, Vdekja e doktorit në Wuhan tregon problemet mbi operacionin kundër lajmeve të rreme në Azi (Wuhan Doctor’s Death Shows Risks of Asia’s Fake News Crackdown), 7 Shkurt 2020.
- 13 Shiko p.sh., T. Boonbandit, Dy persona arrestohen për përhapjen e lajmeve të rreme për koronavirusin (Two arrested for spreading coronavirus fake news,) 30 Janar 2020.
- 14 ARTIKULLI 19, Iran: Kriza e koronavirusit tregon nevojën për rrjedhë të lirë të informacionit (Iran: Coronavirus crisis highlights need for the free flow of information), 27 Shkurt 2020.
- 15 OBSH, Mbi EPI-WIN.

- <sup>16</sup> OBSH, vërejtje nga Drejtori i Përgjithshëm.
- <sup>17</sup> Facebook po vendos 'reklama edukative' me informacione nga OBSH dhe autoritete të shëndetit publik në krye të faqeve me rezultate të kërkimit të informacioneve për koronavirusin; shiko K-X. Jin, Shefi i departamentit të shëndetit në Facebook, T'i ruajmë dhe informojmë njerëzit mbi koronavirusin (Keeping People Safe and Informed About the Coronavirus), 30 Janar 2020, rifreskuar më 3 Mars 2020. Facebook po punon gjithashtu me një rrjet kontrolluesish faktesh për të demaskuar informacione të rreme mbi virusin. Në një postim në Facebook në muajin mars, Mark Zuckerberg njoftoi se kompania do t'i vinte në dispozicion OBSH-së "sado reklama që të ketë nevojë", për të promovuar shpërndarjen e informacioneve të sakta; shiko M. Zuckerberg, postim në Facebook, 4 Mars 2020. Edhe Twitter po promovon informacione të besueshme duke i renditur këto materiale në krye të listës së rezultateve të kërkimit dhe duke bllokuar shfaqjen e rezultateve që të drejtojnë tek faqe jo të besueshme; shiko J. Chu & J. McDonald, Twitter, Po ndihmojmë botën që të gjejë informacione të besueshme mbi #koronavirusin e ri, (Twitter, Helping the world find credible informacioni about novel #coronavirus), 29 Janar 2020.
- <sup>18</sup> Shiko, A. Maryon-Davis, Shpërthime epidemish që mbahen sekret: Mohimi dhe sekretet ndihmuan që të përhapet Ebola, Sars dhe Aids, Treguesi i Censurës (Outbreaks under wraps: How denials and cover-ups spread ebola, Sars and Aids, Index on Censorship), vol. 14(1), 12 Mars 2015.
- <sup>19</sup> Asambleja e Përgjithshme e OKB, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (Universal Declaration of Human Rights – UDHR) 10 Dhjetor 1948, 217 A (III). Megjithëse UDHR është resolutë e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB, ajo nuk ka forcë detyruese mbi shtetet. Sidoqoftë, shumë nga dispozitat e saj konsiderohen se kanë fituar forcë ligjore, si pjesë e legjislacionit ndërkombëtar, që nga miratimi i saj në vitin 1948; shiko: *Filartiga v. Pena-Irala*, 630 F.2d 876 (1980) (Gjykata e Apelit e Qarkut 2 në SHBA - US Circuit Court of Appeals, 2nd circuit).
- <sup>20</sup> Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave Civile dhe Politike (International Covenant on Civil and Political Rights), 16 Dhjetor 1966, Seria e Traktateve (Treaty Series), vol. 999, f. 171.

- <sup>21</sup> Neni 10 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms), 4 Shtator 1950; Neni 9 i Kartës Afrikane të të Drejtave të Njeriut dhe Popujve – Karta Banjul (African Charter on Human and People’s Right - Banjul Charter), 27 Qershor 1981; Neni 13 i Konventës Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut (American Convention on Human Rights), 22 Nëntor 1969.
- <sup>22</sup> ICCPR, Neni 19(2).
- <sup>23</sup> ICCPR, Neni 19(3); Komiteti DN, Koment i Përgjithshme Nr. 34 mbi Nenin 19: Liria e opinionit dhe shprehjes (Freedom of opinion and expression), Dokument i OKB. CCPR/C/GC/34, paragrafët 11 dhe 12.
- <sup>24</sup> *Po aty*, paragrafët 21-36.
- <sup>25</sup> *Po aty*, paragrafi 35.
- <sup>26</sup> *Po aty*.
- <sup>27</sup> *Po aty*, paragrafi 30.
- <sup>28</sup> Koment i Përgjithshëm Nr. 34, paragrafi 38.
- <sup>29</sup> *Po aty*, paragrafi 18.
- <sup>30</sup> *Po aty*, paragrafi 19.
- <sup>31</sup> *Po aty*, paragrafi 7.
- <sup>32</sup> *Po aty*, paragrafi 18 (referuar paragrafit 7 dhe shënimit 7).
- <sup>33</sup> Shiko p.sh. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata Evropiane), *Thorgeirson kundër Islandës (Thorgeirson vs Iceland)*, 25 Qershor 1992, Ap. Nr. 13778/88, paragrafi 63 ose *Castells vs Spain*, 24 Prill 1992, Ap. Nr. 11798/85, paragrafi 43.
- <sup>34</sup> Gjykata Evropiane, *Dichand e të tjerë kundër Austrisë (Dichand and others vs Austria)*, 26 Shkurt 2002, Ap. Nr. 29271/95, paragrafi 40.
- <sup>35</sup> Koment i Përgjithshëm 34, paragrafi. 13.
- <sup>36</sup> Raporti i Raportuesit Special mbi të drejtën e të gjithëve për të gëzuar standardet më të larta të mundshme të shëndetit fizik dhe mendor, 11 Gusht 2008, dokument i OKB. Nr. A/63/263, paragrafi 11.
- <sup>37</sup> Parimet Bazë mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut: Zbatimi i



- Fushatës së OKB “Mburo, Respekto dhe Ndreq” - Parimet e Ruggie (Guiding Principles on Business and Human Rights: Implementing the United Nations “Protect, Respect and Remedy” Framework – The Ruggie Principles). Këshilli i OKB mbi të Drejtat e Njeriut i miratoi Parimet Bazë në rezolutën e këshillit 17/4, A/HRC/RES/17/14, 16 Qershor 2011.
- <sup>38</sup> Parimet Bazë mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut të OKB, e miratuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB më 16 Qershor 2011, dokument i OKB Nr. HR/PUB/11/04.
- <sup>39</sup> *Po aty*, Parimi 11.
- <sup>40</sup> *Po aty*, Parimi 12.
- <sup>41</sup> *Po aty*, Parimi 13(b).
- <sup>42</sup> *Po aty*, Parimi 15.
- <sup>43</sup> *Po aty*, Parimet 17 dhe 18.
- <sup>44</sup> *Po aty*, Parimi 22.
- <sup>45</sup> Raporti i Raportuesit Special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për lirinë e opinionit dhe shprehjes, 6 Prill 2018, Dokument i OKB Nr. A/HRC/38/35 paragrafi 10.
- <sup>46</sup> Raporti i Raportuesit Special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për lirinë e opinionit dhe shprehjes, 9 Tetor 2019, Dokument i OKB Nr. A/74/486, paragrafi 42.
- <sup>47</sup> Deklaratë e Përbashkët, viti 2017, *cituar më lart*, paragrafët 4(a) dhe (b).
- <sup>48</sup> Raporti i Raportuesit Special, Prill 2018, paragrafi 26.
- <sup>49</sup> Deklaratë e Përbashkët, viti 2017, *cituar më lart*, paragrafi 4(c); Raporti i Raportuesit Special, Prill 2018, paragrafët 37-38.
- <sup>50</sup> UDHR, neni 25(1).
- <sup>51</sup> Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 16 Dhjetor 1966, Seria e Traktateve, vol. 993, faqe 3, neni 12.
- <sup>52</sup> *Po aty*, paragrafi 16
- <sup>53</sup> Shiko, ARTIKULLI 19, Njohuri e shëndetshme: E drejta për informim dhe e drejta për shëndet (A Healthy Knowledge: Right to information and the right to health), 2012.

- <sup>54</sup> Komiteti mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Koment i Përgjithshëm Nr. 14: E drejta për standardet më të larta të mundshme të shëndetit (The Right to the Highest Attainable Standard of Health) neni 12, miratuar më 11 Gusht 2020, dokument i OKB E/C.12/2000/4, paragrafi 12(b).
- <sup>55</sup> *Po aty*, paragrafi 34.
- <sup>56</sup> Këshilli i të Drejtave të Njeriut, Raporti i Raportuesit Special për të drejtën e kujtdo për të gëzuar standardet më të larta të mundshme të shëndetit fizik dhe mendor, Paul Hunt, 31 Janar 2018, Dokument i OKB A/HRC/7/11, paragrafi 40.
- <sup>57</sup> Koment i Përgjithshëm Nr. 14, *cituar më lart*, paragrafi 50.
- <sup>58</sup> *Po aty*, parathënie.
- <sup>59</sup> Deklaratë e Përbashkët, viti 2017, *cituar më lart*
- <sup>60</sup> *Po aty*, paragrafi 2(a).
- <sup>61</sup> Shiko p.sh., ARTIKULLI 19, Tajlandë: Ligji kundër krimeve kompjuterike (Thailand: Computer Crime Act), 31 Janar 2017; ARTIKULLI 19, Singapore: Ligji i ri mbi “falsitete në internet” është një kërcënim i madh ndaj lirisë së shprehjes (Singapore: New law on “online falsehoods” a grave threat to freedom of expression) 9 Maj 2019; ose ARTIKULLI 19, Malajzi: Ligji mbi Komunikimet dhe Multimedian duhet të ndryshohet urgjentisht, (Malaysia: Communications and Multimedia Act must be urgently revised), 24 Mars 2017.
- <sup>62</sup> Shiko Koment i Përgjithshëm 34, *cituar më lart*, paragrafi 25.
- <sup>63</sup> Koment i Përgjithshëm 34, paragrafet 34 dhe 46 - 49, lexo bashkë me ICCPR, neni 20(2).
- <sup>64</sup> Deklaratë e Përbashkët, viti 2017, *cituar më lart*, parathënie. Raportuesit identifikuan rastet e keqinformimit të organizuara nga shtetet dhe propagandën si një rrezik të madh ndaj të drejtës së publikut për të marrë informacion.
- <sup>65</sup> Shiko J. Dalton Mike Pompeo refuzon të hedhë poshtë teoritë e konspiracionit se koronavirusi është një sajese për të dëmtuar Trumpin, (Mike Pompeo refuses to deny conspiracy theories that coronavirus is hoax created to damage Trump), Independent, 1 Mars 2020; ose J. Palmer, Pekini e di kë të fajësojë për virusin:

- Amerikën (Beijing Knows Who to Blame for the Virus: America), FT, 2 Mars 2020.
- <sup>66</sup> ARTIKULLI 19, Iran: kriza e koronavirusit (Iran: Coronavirus crisis), *cituar më lart*
- <sup>67</sup> Koment i Përgjithshëm Nr. 34, *cituar më lart*, paragrafi 34; Raporti i Raportuesit Special mbi promovimin dhe mbrojtjen e së drejtës për lirinë e opinionit dhe shprehjes, 9 Tetor 2019, Dokument i OKB Nr. A/74/486, paragrafi 15.
- <sup>68</sup> Resoluta 16/18 e Këshillit për të Drejtat e Njeriut (HRC) mbi luftën kundër intolerancës, stereotipeve negative dhe stigmatizimit, diskriminimit, nxitjes dhe ushtrimit të dhunës kundër të tjerëve duke u bazuar mbi besimet apo fenë e tyre, dokument i OKB A/HRC/Res/16/18, 24 Mars 2011.
- <sup>69</sup> Plani i punës së Rabatit mbi ndalimin e mbështetjes dhe nxitjes së urrejtjes kombëtare, racore apo fetare, që cilësohen si nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë. Dokument i OKB A/HRC/22/17/Add.4, 5 Tetor 2012.
- <sup>70</sup> OBSH, UNICEF, dhe Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq, Stigma sociale që shoqëron COVID-19, (Social Stigma associated with COVID-19)
- <sup>71</sup> Shiko raportimin e Komitetit për Mbrojtjen e Gazetarëve (Committee to Protect Journalists), Njoftime urgjente.
- <sup>72</sup> Deklaratë e Përbashkët, *cituar më lart*, paragrafët 5(a) dhe (b); ARTIKULLI 19, Parimet Camden mbi lirinë e shprehjes dhe barazinë, 30 Prill 2009, Parimi 7.
- <sup>73</sup> Parimet Camden, *cituar më lart*, Parimet 6, 7 dhe 9.
- <sup>74</sup> *Po aty*.
- <sup>75</sup> *Cituar më lart*
- <sup>76</sup> Shiko Raportin e Raportuesit Special, *cituar më lart*, Prill 2018, paragrafi 31; Raporti i Raportuesit Special, *cituar më lart*, Tetor 2019, paragrafi 51.
- <sup>77</sup> *Cituar më lart*.
- <sup>78</sup> Deklaratë e Përbashkët, viti 2017, *cituar më lart*, paragrafi 4(e).
- <sup>79</sup> Parimet Bazë, *cituar më lart*, Parimi 22(b).

- <sup>80</sup> Parimet e Manilës mbi përgjegjësinë e ndërmjetësve (Principles on Intermediary Liability), 24 Mars 2015, <https://www.manilaprinciples.org/>.
- <sup>81</sup> *Po aty*, parimi 1; ose Raporti i Raportuesit Special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për lirinë e opinionit dhe shprehjes, 30 Mars 2017, Dokument i OKB Nr. A/HRC/35/22, paragrafi 49; Deklarata e Përbashkët e vitit 2017, *cituar më lart*, paragrafi 1(2).
- <sup>82</sup> Raporti i Raportuesit Special, Mars 2017, paragrafi 70.
- <sup>83</sup> Raporti i Raportuesit Special, Prill 2018, paragrafi 40.



Ethical  
Journalism  
Network

# ETIKA E MEDIAS, SIGURIA DHE SHËNDETI MENDOR: RAPORTIMI NË KOHËN E COVID-19



Gjatë shumicës dërrmuese të dekadës së kaluar, kam punuar për sigurinë e gazetarisë, dhe së fundmi për etikën e mediave, thotë Hannah Storm, drejtore e Rrjetit të Gazetarisë Etike, një organizatë që promovon etikën profesionale (Instituti Shqiptar i Medias është pjesë e këtij rrjeti).

Por, në përvojën time, shkruan ajo, asgjë nuk krahasohet me ngjarjet e javëve të fundit për sa i përket ndikimit global të Covid-19 në mediat e mbarë botës dhe shkallës së pakrahasueshme të tyre, si dhe kërkesave që shtrohen para gazetarisë dhe ne gazetarëve.

Organizatave të lajmeve u është dashur të rishikojnë dekada të tëra praktikë pune në pak ditë. Një numër i madh i gazetarëve janë në vetizolim ose të karantinuar, udhëtimi midis dhe brenda vendeve është reduktuar. Ndërkohë që Covid-19 përhapet, përhapen gjithashtu edhe nivelet e ankthit rreth asaj që dimë dhe nuk dimë, cilin dhe çfarë të besojmë dhe si të qëndrojmë të sigurt - fizikisht dhe mendërisht - si gazetarë që punojmë në kohë të trazuara.

Konsideratat e mëposhtme janë mbledhur nga përvojat, ekspertiza dhe bisedat me kolegët. Ju lutem, kini parasysh se unë nuk jam as avokate, as kliniciste. Disa nga informacionet më poshtë u referohen organizatave të tjera që bëjnë punë të vlefshme në këtë fushë. Kjo listë nuk është shteruese.

Sidoqoftë, asnjë nga këto nuk është një zëvendësim i informacionit zyrtar të siguruar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë ose shërbime të shëndetit publik dhe autoritete në secilin vend.

## 1. Gazetaria e përgjegjshme dhe etike është thelbësore për raportimin e Covid-19

---

Në fillim të këtij muaji, unë tweet-ova një listë rekomandimesh për gazetarët që mbulojnë koronavirusin. Të gjitha ishin të mbështetura në ato që, në Rrjetin e Gazetarisë Etike, ne i konsiderojmë si parimet thelbësore të gazetarisë etike: *e vërteta dhe saktësia, ndershmëria dhe paanshmëria, humanizmi, përgjegjshmëria dhe pavarësia*. Këtu është një version i përditësuar i atyre sugjerimeve:

**Shmangni sensacionalizmin dhe frikësimin** në gjuhë dhe imazhe që mund të rrisin ankthin; për shembull, fotografi të rafteve të boshatisura të supermarketeve, grumbullimin e ushqimeve, detaje që mund të ndezin tensione dhe të krijojnë më shumë panik.

**Shmangni profilizimin racor** - nuk keni nevojë të përsërisni ku u krijua virusi sa herë që raportoni raste të reja. Që nga shkrimi i këtij artikulli, fokusi gjeografik i virusit ka lëvizur, por ka ende shembuj të racizmit dhe diskriminimit në raportimin kundër grupeve të caktuara të njerëzve.

**Sigurohuni që të mbronni personat e prekur:** mos identifikoni emrat, imazhet ose materialin identifikues pa lejen e personave përkatës. Sidoqoftë, vlen të përmendet se ditët e fundit, një numër personash me profil të lartë kanë marrë vendimin të shpallin se janë infektuar me Covid-19.

**Jini të saktë dhe raportoni fakte:** shmangni thashethemet dhe përpikuni të mos spekuloni; gjendet në qarkullim një sasi e madhe dezinformacioni, prandaj jini të vetëdijshëm se si ta pikasni dhe demaskoni dezinformimin.



**Kërkoni mendime të ekspertëve** - nga mjekë dhe shkencëtarë që gëzojnë besueshmërinë e duhur - por kini parasysh se këshillat shkencore shpesh ndryshojnë.

**Ofroni kontekst** dhe tregojuni njerëzve burime të informacionit të besueshme dhe me autoritet.

**Kini kujdes kur përdorni harta që tregojnë përhapjen e rasteve** - përsëri përdorni kontekstin dhe ofroni burime; dhe jini të vetëdijshëm për kufizimet e testimit.

**Jini të kujdesshëm në përdorimin e imazheve të njerëzve me maska** - pyesni veten nëse ato kanë vlerë si lajm apo nëse thjesht tërheqin vëmendjen. Vëreni që ka informacione kontradiktore në lidhje me efikasitetin e llojeve të ndryshme të maskave dhe mbulesave të fytyrës, dhe çfarë nivelesh të mbrojtjes ofrojnë këto; pasi me aq shumë informacione rreth Covid-19, duhet të merren këshillat e ekspertëve dhe përgjigjet dhe raportimi duhet të kontekstualizohen.

## 2. Qëndroni të sigurt fizikisht

---

Si gazetarë, është detyra jonë të marrim lajmin. Por kjo nuk duhet të jetë në dëm të shëndetit tonë.

Me Covid-19, situata po ndryshon aq shpejt sa gazetarët dhe organizatat e lajmeve duhet të përditësohen në vijimësi me këshillat e qeverive dhe autoriteteve përkatëse, si për sa i përket ndikimit në lëvizjen e mediave, ashtu dhe përputhjes me udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe të shërbimeve shëndetësore përkatëse.

Gazetarët duhet të jenë vazhdimisht të vetëdijshëm për shëndetin e tyre dhe, nëse shfaqin ndonjë nga simptomat e virusit, ata duhet të informojnë punëdhënësit e tyre dhe duhet të ndjekin politikat e qeverisë dhe vendit ku punojnë.

Gazetarët me disa kushte shëndetësore që përfshihen në grupet e rrezikuara nuk duhet ta mbulojnë këtë temë.

Gazetarët duhet të jenë te vetëmjaftueshëm në rrethana të tilla, dhe të sigurohen se nuk mbështeten në shërbimet ose furnizimet e komuniteteve tashmë të prekura, të cilat do të jenë nën presion. Ata duhet të kryejnë vlerësimet e duhura të rrezikut dhe të jenë të vetëdijshëm për pajisjet e nevojshme për mjediset të veçanta (kjo mund të ndryshojë sipas vendndodhjes dhe me kalimin e kohës.)

Të gjithë gazetarët duhet të kenë plane emergjence, të cilët i kanë ndarë me menaxherët e tyre në rast se ata sëmuren ose shpallen të paaftë për të lënë vendin ku punojnë.

Nëse gazetarët raportojnë aty ku popullsia e vendit është e detyruar të qëndrojë në shtëpi, atëherë ata duhet të sigurojnë që kanë pajisjet e duhura - përfshirë maskat N95, dorezat e nitrilit dhe syzet e sigurisë. Ata gjithashtu duhet të qëndrojnë dy metra larg të tjerëve. Veshjet dhe pajisjet duhet të pastrohen siç duhet.

### 3. Si ta menaxhoni shëndetin tuaj mendor si gazetar

---

Fola me profesorin Anthony Feinstein se çfarë mund të bëjnë gazetarët për t'u kujdesur për shëndetin e tyre mendor në këtë kohë, që kuptohet që është stresuese për shumë njerëz.

Së pari, është e rëndësishme të njihni shërbimin e vlefshëm që gazetaria ofron duke ofruar informacion jetësor për komunitetet e prekura nga krizat. Ky është edhe rasti me koronavirusin, siç ka qenë në kriza të tjera shëndetësore dhe ngjarje të mëdha si fatkeqësi dhe konflikte.

Megjithëse ky është një lajm i madh dhe i rëndësishëm, nuk duhet t'i bjerë ndesh shëndetit tonë.

Këtu janë sugjerimet e profesorit Feinstein, së bashku me të dhënat e përvojave të mia, shkruan me tej autorja.

Bëni një listë të gjërave që mund t'i kontrolloni dhe atyre që nuk mund t'i kontrolloni: *Për shembull, nuk mund ta kontrolloni virusin, nuk mund të kontrolloni përgjigjet e qeverive, tregjet e aksioneve, sjelljen e të tjerëve. Sidoqoftë, ju mund të kontrolloni sjelljen tuaj, dhe kështu elementet e mëposhtme mund t'ju ndihmojnë:*

- Puna juaj është e rëndësishme. Por edhe shëndeti juaj, gjithashtu.
- Sigurohuni që po flini mjaftueshëm.
- Hani si duhet; mundohuni të shmangni alkoolin dhe kafeinën e tepërt, të cilat mund të rrisin ankthin.
- Bëni një pushim nga puna, në mënyrë dixhitale dhe fizike.
- Fikni lajmet dhe rrjetet sociale.

- Pranoni që është normale të ndiheni të prekur nga imazhe ose lajme të sikletshme.
- Nëse keni mundësi të shëtisni, atëherë bëjeni këtë.
- Nëse nuk mund të dilni jashtë, përpiquni të gjeni një mënyrë tjetër për të pushuar: p.sh. të shihni imazhe që ju bëjnë të lumtur (kafshët për shembull); të provoni meditimin; të shikoni një komedi, të lexoni një libër
- Kaloni kohë me familjen nëse mundeni, dhe me miqtë po qe e mundur - edhe nëse kryhet vetëm në distancë. Ndërkohë që shumë nga ne punojmë në distancë, izolimi mund të jetë një problem i madh, dhe izolimi mund të ushtrojë presion në shëndetin tuaj mendor.
- Nëse keni nevojë për të marrë pushim nga puna, nëse nuk jeni mirë, mendërisht ose fizikisht, mos kini frikë të pyesni. Shpesh ne gazetarët nuk jemi shumë të zot për të kërkuar ndihmë. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë, ka të ngjarë të bëhemi më keq dhe të jemi më pak në gjendje të punojmë.
- Nëse jeni drejtues i redaksisë, sigurohuni që po udhëhiqni me shembullin tuaj. Jini i qartë për politikat dhe prioritetet; jini sa më transparent që të mundeni, edhe pse gjërat ndryshojnë shpejt, edhe nëse po punoni nga distanca; jini i vetëdijshëm veçanërisht për ata që mund të jenë më vulnerabël në këto situata.

Profesori Feinstein këshillon që duke njohur atë që ju mund të kontrolloni, ju po i siguron vetes një ndjesi zotërimi mbi atë që po ndodh. Nëse ju cenohet një ndjesi e tillë, atëherë të gjitha pasiguritë - gjërat që nuk mund t'i kontrolloni - do të zmadhohen.

Muajt e fundit kanë qenë të jashtëzakonshëm për sa i përket shkallës së lajmeve që gazetarëve shpesh u është dashur të

menaxhojnë dhe trysnisë ku janë gjendur për shkak të natyrës shpesh të pamëshirshme të lajmeve të fundit.

Duke njohur gjërat që nuk mund të kontrolloni dhe duke pranuar që ky është rasti, ju do të shpenzoni më pak energji emocionale dhe do të keni më pak mundësi të dorëzoheni.

Fakti është se nuk e kemi në dorë për sa kohë do të vazhdojë kjo histori, dhe gjasat janë që të zgjasë për një kohë të gjatë. Pasiguria e dukshme e mosnjohjes shton ankthin. Të gjithë duhet të përgatisim veten për një kohë të gjatë.





DHJETË KËSHILLA  
PËR MEDIAT GJATË  
'INFODEMISË' SË  
COVID-19





Bashkë me pandemitë vjen nje fenomen i njohur, “infodemia”, e cila mund të jetë po aq e dëmshme sa virusi vetë, ose më shumë. Për të zbutur riskun që thashethemet, mis- dhe disinformacioni mund të shkaktojë, BBC Media Action sjell 10 këshillat kryesore për mediat qe raportojnë perhapjet e sëmundjeve dhe emergjencave shendetësore publike për t’u siguruar që audienat të mbeten të informuara, të lidhura me shërbimet qe u nevojiten, dhe të inspiruara per t’u perballur.

Të raportosh në një krizë shpesh herë do të thotë të raportosh numrin e të vdekurve, vuajtjet njerëzore dhe rastet e dështimit të qeverive. Por, po aq e rëndësishme është të japësh informacion të saktë dhe të besuar për të cilin njerëzit kanë nevojë për t’i bërë ballë situatës dhe për të mbijetuar.

Ndërkohë që shpërthimi i COVID-19 vazhdon, Drejtori i Përgjithshëm i OBSH i është referuar një ‘info-demie’ që shoqëron virusin. Thashethemet, mis-informacioni dhe disinformacioni, për kurat e rreme apo menyrat e përhapejes së sëmundjes, mund të jenë po aq të dëmshme sa vetë virusi.

BBC Media Action që ka punuar me një numër partnerësh – përfshirë Federatën Ndërkombëtare te Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Organizatën Botërore të Shendetësisë, Përkthyesit pa Kufij dhe te tjerë – per të përballuar këto lajme të rreme apo thashetheme të dëmshme duke ndihmuar që raportimi të jetë për njerëzit e prekur, jo thjesht mbi ata.

Më poshtë keni këshillat kryesore për raportimin në media të përhapjeve të sëmundjeve dhe emergjencave shëndetësore publike për t’u siguruar që audienat të informohen, të lidhen me shërbimet që kanë nevojë, dhe të inkurajohen për t’i dalë ballë situatës.

1. **Jini të përgatitur.** Krijoni kontakte me reaguesit e emergjencës, organizatat shëndetësore dhe ekspertët që më përpara. Diskutoni çfarë mund t'i duhet publikut përtej lajmeve më të fundit.
2. **Bëni kërkime.** Njihuni me informacionet bazike për parandalimin, transmetimin dhe trajtimin e sëmundjes dhe konsultohuni me ekspertë për të siguruar raportimin e informuar.
3. **Koordinoni.** Në një emergjencë të shëndetit publik, media dhe autoritetet shëndetësore duhet të punojnë bashkë për të ofruar informacion të fundit, të qartë dhe konsistent.
4. **Ndihmoni audiencën që të qëndrojë e shëndetëshme.** Ofroni informacion të saktë mbi çfarë po ndodh, dhe shpjegoni masat e emergjencës që po merren, përfshirë si dhe kur njerëzit të kërkojnë ndihmë, si të parandalojnë përhapjen e sëmundjes dhe çfarë të bëjnë nëse ata ose pjesëtarë të familjes së tyre kanë simptoma.
5. **Përfshini zëra të besuar, dhe kundërshtoni mis-dhe dis-informacionin.** Njerëzit veprojnë bazuar në informacione dhe udhëzime vetëm nëse u besojne atyre dhe kjo pjesërisht lidhet me faktin se nga vjen ky informacion. Kë do të besojë audiencia? Dhe, a janë burimet e informacionit të besueshme?
6. **U bëni pyetjet e duhura njerëzve të duhur.** Zgjidhni njerëz me njohurinë, besueshmërinë dhe aftësinë që të shprehen mbi temën. Këta mund të mos jenë gjithmonë ekspertë.
7. **Motivoni audiencat të përballen me situatën.** Tregoni histori pozitive përballimi dhe shërimi dhe ndani eksperiencën dhe njohuri nga të tjerët e prekur. Mendoni në mënyrë kreative: njoftimet e shkurtëra të shërbimit

publik, segmentet më të gjata në stil dokumentar, madje edhe kënet tërheqëse mund të arrijnë tek njerëzit me informacione që mund të shpëtojnë jetë.

8. **Bashkëveproni me audiencën tuaj.** Por, kujtoni që duhet të ruani veten dhe audiencën – gjatë një përhapje sëmundjeje, telefonatat ose diskutimet online mund të jenë më të sigurta se bashkëveprimet në person. Dhe mos harroni zërat e atyre që janë më vulnerabël, të cilët mund të jenë më të vështirë për t'u arrirë.
9. **Mos bëni dëm.** Nuk mjafton vetëm të siguroheni që informacioni juaj është i saktë. Konsideroni se si raportimi juaj mund të interpretohet dhe nëse mund të jetë duke ushqyer stigmë ose diskriminim - për shembull duke asociuar një grup të veçantë me përhapjen e një problemi shëndetësor. Dhe, bëhuni empatikë dhe të ndjeshëm. Nevojat e dikujt të prekur nga sëmundja janë gjithmonë më të rëndësishme sesa nevojat e intervistuesit.
10. **Mendoni për pamjen e plotë.** Përhapja e sëmundjeve dhe emergjencat shëndetësore prekin më shumë sesa shëndetin e njerëzve. Mjetet e jetesës, arsimi, rutina e përditshme, e drejta për ushqim dhe kujdesi i zakonshëm shëndetësor ka të ngjarë të preken nga përhapja e sëmundjes.

Mbi të gjitha, **komunikoni mirë**. Kjo mund të duket e evidente! Por, për të siguruar që programet të jenë sa më të arritshëm dhe të dobishëm, ato duhet të jenë të qarta dhe të sakta, realiste, angazhues dhe të orientuar drejt zgjidhjeve. Programimi i besueshëm, i qëndrueshëm dhe praktik shpëton jetë.





KONSIDERATA ETIKE  
PËR RAPORTIMIN MBI  
COVID-19



Qëkur Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e shpalli Coronavirusin e ri (COVID-19) një pandemi, gjithnjë e më shumë gazetarë në të gjithë botën janë tërhequr për të raportuar në vijat e para të krizës globale, shkruan Senami Kojah për IJNet.

Origjina dhe përhapja e virusit, reagimi i qeverive dhe individëve dhe retorika që ka pasuar paraqesin një seri dilemash unike për gazetarët që navigojnë në të panjohurën. Të kuptuarit se si t'i perballojme konsideratat etike është e rëndësishëm për të dhënë një raport të ekuilibruar, të drejtë dhe të saktë të asaj që po ndodh gjatë pandemisë.

## Raportimi i lajmeve për vdekjen

---

Kur raportoni lajmet e fundit për vdekjet nga komplikimet për shkak të COVID-19 - veçanërisht kur është i përfshirë një personalitet i shquar - gazetarët duhet të konsiderojnë të largohen nga emocioni i raportimit të ngjarjes dhe të marrin pak kohë për të verifikuar me policinë ose autoritetet lokale nëse familja e të ndjerit është informuar.

Pas të dhënave, ka jetë njerëzore të cilat do të preken nga humbja e një të dashuri. Gazetarët duhet të jenë të kujdesshëm për të mos ofenduar ndjeshmërinë e audiencës së cilës i shërbejnë.

“Shifrat e vdekjeve janë fakte, dhe faktet mbeten themeli i gazetarisë. Besoj se botimi i shifrave të vdekjeve duhet të bëhet me gjuhën e duhur, e cila tregon ndjeshmëri dhe respekt për jetën e njeriut”, thotë Eniola Akinkotu, një gazetar në vijën e parë të raportimit për COVID- 19 për gazetën më të lexuar të Nigerisë, Punch.

Në një histori mbi qasjet etike për të raportuar mbi vdekjen, Sal Lalji, menaxher i shtypit dhe marrëdhënies me publikun në Samaritans, inkurajon gazetarët të bisedojnë me familjet para se të përdorin imazhe nga media sociale për një shkrim. “Kur një person vdes, nëse ata janë në qendër të një lajmi, në të vërtetë mund të jetë mjaft shqetësuese të shohësh imazhe që ka marrë media nga faqet e rrjeteve sociale, pasi këto nuk janë imazhe me të cilat domosdoshmërisht një familje e prekur do të donte që ky individ të kujtohet.”



## Respektimi i konfidencialitetit të burimeve

---

Gazetarët mbështeten në burime për të dhënë informacione nga brenda, të cilat përndryshe nuk do të ishin në gjendje t'i aksesonin. Natyra e paparë e mbulimit të COVID-19 do të thotë se shumë informacione vijnë nga njerëz që janë në vijat e para të pandemisë.

Çdo burim duhet të pyetet nëse ata mund të identifikohen me emër në një histori, veçanërisht burime që mund të jenë të ndjeshme ndaj përdorimit të informacionit të tyre. Këtu përfshihen infermierë, mjekë, sinjalizues në spitale dhe institucione qeveritare, staf i pakënaqur, burime që ofrojnë informacion mbi trajtimin dhe menaxhimin e pacientëve, dhe njerëz që kanë dijeni për mbulimin e shifrave të viktimave ose të shkallës së infeksionit.

Gazetarët kurrë nuk duhet të supozojnë se burimet e tyre dëshirojnë të emërtohen. Është thelbësore të kërkohet miratimin e tyre dhe të reflektosh atë që ata të lejojnë të japësh për shkrimin.

Është gjithashtu e rëndësishme të siguroheni që burimet nuk janë të identifikueshme nga konteksti.

Manuali i Lajmeve ofron një shembull: “Sekretari i Kryeministrit mund t’ju ketë dhënë informacione sekrete në confidence ose off rekord. Nëse shkruani shkrimin duke iu referuar ‘burimeve në stafin personal të Kryeministrit’, rrezikoni të ekspozoni burimin tuaj, veçanërisht nëse ka vetëm një ose dy persona në stafin e tij personal. Mund të jetë më mirë t’i referoheni ‘burimeve në departamentin e Kryeministrit’ nëse është një departament i madh ... Ju duhet të balanconi nevojën për të

treguar që burimet tuaja janë afër qendrës së informacionit (dhe për pasojë të besueshme), përkundrejt nevojës për të mbrojtur identitetin e një burimi konfidencial.”

Ruajtja e konfidencialitetit të burimit tuaj është e rëndësishme nëse doni që t’ju besohet me më shumë informacion në të ardhmen.

## Verifikimi i të dhënave

---

A mund të verifikohen të dhënat tuaja? Kjo është pyetja më e rëndësishme për gazetarët që përdorin të dhëna gjatë pandemisë COVID-19. Ka shumë të dhëna që vijnë nga vende dhe organizata të ndryshme gjatë pandemisë që tregojnë shifrat e viktimave, fondet e alokuara për pajisjet mjekësore dhe ndikimin e virusit në jetën në përgjithësi.

Por të dhënat mund të jenë të gabuara, të keqpërfaqësuara, të mos kenë kontekst dhe madje të sajohen/shpiken, prandaj, gazetarët duhet të shfrytëzojnë plotësisht verifikimin dhe hetimin profesional.

Në një artikull mbi vizualizimet e të dhënave të koronavirusit, Joel Selanikio, një ish-investigues i Qendrës për Kontrollin e Sëmundjeve tregon se si hartat e përdorura nga CNN dhe The New York Times për të “ndjekur pandeminë” mund të shtrembërojnë të dhënat.

Për shkak të dizajnit të një harte, dukej sikur i gjithë territory i Kinës ishte prekur nga virusi në fillim të shkurtit, ndërsa në të vërtetë kishte vetëm rreth 35 mijë raste në një popullsi prej 1.4 miliardë njerëzish - duke prekur vetëm 0.002% të popullates kineze. Në një shembull tjetër, në një hartë e CNN që tregon përhapjen globale të “koronavirusit”, Amerika e Veriut, Europa, Australia dhe Rusia, së bashku me Kinën, janë infektuar në mënyrë solide. Por në kohën e botimit, kishte vetëm 12 raste në SHBA, në një popullsi prej 330 milion.

Përdorimi i numrit kumulativ të rasteve kur raportoni mund të jetë i dobishëm në krahasimin e COVID-19 me shpërthime të tjera si SARS, por nuk mund të jetë i besueshëm për gjurmimin në kohë reale, sepse ai nuk zbret kurrë. Shumë njerëz janë

rikuperuar, disa kanë vdekur dhe disa janë ende duke marrë trajtim, kështu që nuk mund të përdoret për të vlerësuar trendin e pandemisë.

Gazetarët duhet ta bëjnë këtë dallim për të siguruar që të dhënat që ata i shfaqin audiencës së tyre nuk janë statike dhe mund të përdoren për të gjurmuar progresin në kohë reale pa nënvlerësuar ose mbivlerësuar ndikimin e pandemisë.

## Raportimi i racizmit dhe hate speech-it

---

Që nga perhapja e COVID-19, gazetarët janë përballur me sfidën e raportimit të hate speech dhe racizmit nga udhëheqësit kryesorë botërorë dhe aktorët e industrisë. Në SHBA, për shembull, Presidenti Donald Trump haptas dhe në mënyrë të përsëritur i referohet COVID-19 si “virusi kinez”, duke ngjallur frikën e veprimeve të urrejtjes me motive raciale.

Shefi i Organizatës Botërore të Shëndetit, Tedros Adhanom Ghebreyesus, tha se ai ishte nënshtruar komenteve raciste dhe kërcënimeve me vdekje për muaj të tërë për shkak të punës së tij, ndërsa mbikëqyrte reagimin global ndaj pandemisë.

Media është më pak e vetëdijshme, ose ndoshta më konfuzë, në lidhje me përgjegjësinë e saj për të mbuluar newsmaker-at që mbrojnë intolerancën. Kjo është pjesërisht sepse çështjet janë vërtet komplekse, dhe nuk janë të përshtatshme për formulat e thjeshta etike. Praktikrat më të mira nënkuptojë paralajmërimin e shoqërisë ndaj agentëve të urrejtjes, por pa u dhënë atyre një udhëtim falas që ekzagjeron rëndësinë e tyre dhe amplifikon pikëpamjet e tyre në mënyrë jo kritike. Mund të jetë e vështirë të arrish ekuilibrin e duhur, sipas Rrjetit Etik të Gazetarisë.

Hate speech-i nuk duhet të ‘festohet’ kurrë në tituj në mënyrë që përcuesit e saj të mos ndiehen të respektuar. Raportimi i reagimeve ndaj hate speech-it mund të jetë një mënyrë më e mirë për të treguar historinë, thotë Akinkotu, reporteri për Punch në Nigeri, gjë që ka rezultuar e dobishme në raportimin e tij.

Raportimi i COVID-19 duhet të bëhet me respektimin maksimal për jetët dhe sensibilitetet njerëzore, veçanërisht në këtë kohë pasigurie të madhe.

